



MANUAL I KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT

**ZGJEDHJET
PËR
KRYETARIN E
BASHKISË KAVAJË**



7 MAJ 2017

Kodi i sjelljes për komisionerët zgjedhorë

Për t'iu përmbajtur parimeve bazë të administrimit të zgjedhjeve, siç parashikohet në ligj, në mënyrë të veçantë kërkesave për legjitimitet, transparencë, paanshmëri dhe profesionalizëm, komisionerët zgjedhorë duhet:

- Të zbatojnë Kodin Zgjedhor, vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së dhe t'i përmbushin plotësisht detyrimet e tyre, për të siguruar zgjedhje të standardeve ndërkombëtare të lira, të drejta dhe transparente.
- Të punojnë për t'i ofruar çdo votuesi cilësinë më të lartë të shërbimit të kërkuar për t'u mundësuar votuesve të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të sigurojnë zhvillimin e zgjedhjeve demokratike.
- Të kryejnë detyrën me profesionalizëm, në mënyrë të pavarur, transparente dhe të paanshme.
- Të marrin vendime të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor.
- Të zhvillojnë mbledhje të hapura për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, përfshirë edhe aksesin e lirë në informacionin, mbi bazën e të cilit merren vendimet.
- Të kryejnë të gjitha detyrat e tyre në mënyrë rigoroze dhe politikisht neutrale.
- Të trajtojnë të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor (kandidatët, partitë politike dhe votuesit) në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, pa i dhënë avantazh ndonjë partie politike apo grupi interesi.
- Të trajtojnë përfaqësuesit e mediave me mirësjellje dhe respekt.
- Të jenë të trajnuar dhe disiplinuar, si dhe të angazhuar të trajtojnë materialet zgjedhore me kujdes dhe respekt.
- Të respektojnë standardet më të larta të etikës në lidhje me komisionerët e tjerë zgjedhorë, kandidatët, vëzhguesit dhe votuesit.
- Të sillen në mënyrë të pagabueshme, të ushtrojnë gjykim të shëndoshë dhe të kenë standardet më të larta të maturisë profesionale.
- Të mos pranojnë ndonjë dhuratë apo favor nga partitë politike, organizatat apo personat, të cilët mund ose jo të jenë të përfshirë në procesin zgjedhor.
- Gjatë ushtrimit të detyrës të mos mbajnë apo tregojnë simbole apo ngjyra partiake.
- Të mos shprehin pikëpamje mbi tema, të cilat mund të jenë çështje politike në zgjedhje.
- Të mos marrin pjesë në aktivitete të paautorizuara, përfshi edhe aktivitetet private, që mund të çojnë drejt një konflikti aktual apo të perceptuar interesi me detyrat e tyre si administrues zgjedhorë.
- Të deklarojnë çdo marrëdhënie që mund të çojë në konflikt interesi me detyrat e tyre.

KODI I SJELLJES.....	2
Përmbajtja e lëndës	3
Shkurtime të përdorura në Manual.....	5
I. KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT.....	5
1. Përbërja dhe detyrat e KQV.....	5
1.1 Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së.....	6
1.2 Plotësimi i vakancës.....	6
2. Detyrat e kryetarit të KQV-së.....	7
3. Detyrat e sekretarit të KQV-së.....	14
4. Detyrat e anëtarëve të KQV-së.....	22
5. Mbledhjet dhe vendimet e KQV-së.....	24
5.1 Mbledhjet e KQV-së.....	24
5.2 Vendimet e KQV-së.....	24
5.3 Modelet e vendimeve të KQV-së.....	25
5.4 Modelet e dokumentacionit të punës.....	25
6. Veprime të KQV-së përpara hapjes së qendrës së votimit.....	26
6.1 Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore nga KQV.....	26
6.2 Marrja në dorëzim e vulave metalike me kodet e sigurisë.....	27
6.3 Marrja në dorëzim e vulës së kryetarit të KQV-së.....	27
6.4 Lista e zgjedhësve.....	28
6.5 Ruajtja e materialeve zgjedhore një ditë para ditës së zgjedhjeve.....	28
II. ORGANIZIMI I QENDRËS SË VOTIMIT.....	29
1. Organizmi i qendrës së votimit.....	29
III. VËZHGESIT.....	31
IV. PROCEDURAT PËR HAPJEN E VOTIMIT.....	32
1. Veprimet paraprake të KQV-së.....	32
V. VOTIMI.....	34
1. Personat e autorizuar për të qënë të pranishëm në qendrën e votimit.....	34
2. Prania e anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së gjatë votimit.....	34
3. Përdorimi i vulave.....	34
3.1 Pajisja e KQV-së, menjëherë, me vulë rezervë, në rast se.....	35
VI. PROCEDURAT GJATË VOTIMIT.....	35
1. Paraqitja e zgjedhësit në QV dhe votimi.....	36
2. Regjistri i Posaçëm i Zgjedhësve, zgjedhësit e veçantë.....	37
3. Votuesit që nuk mund të votojnë vetë.....	38
4. Fletë votimi të dëmtuara.....	39
5. Dërgimi i informacionit për pjesëmarrjen në votim.....	40
VII. MBYLLJA E VOTIMIT.....	40
1. Votuesit në radhë.....	40
2. Vendimi për mbylljen e votimit.....	41
3. Veprimet pas mbylljes së votimit.....	41
4. Dërgimi i kutisë së votimit me fletët e votimit dhe i kutisë së materialeve të votimit në VNV.....	44
VIII. PËRGJEGJËSI TË DHE SANKSIONET.....	45
1. Rastet e përgjegjësisë penale dhe administrative të anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së.....	46
2. Veprat Penale.....	47
❖ Model Procesverbal i PV-KQV-07.....	49
❖ Model Procesverbal i PV-KQV-08.....	50
❖ TEST MATËS I NJOHURIVE.....	51
❖ PËRGJIGJET E TESTIT.....	57

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Qendrës së Votimit!

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke ju uruar për emërimin në detyrë, për përmbushjen sa më profesionalisht të detyrave tuaja, ju vjen në ndihmë me Manualin e Komisionit të Qendrës së Votimit. Ky Manual, do të përdoret nga anëtarët e KQV-së dhe ju këshillojmë ta mbani si udhërefyës në punën tuaj një ditë para ditës së zgjedhjeve dhe gjatë ditës së votimit.

Duke ju referuar Manualit e KQV-së, çdo komisioner dhe çdo i interesuar, do të kuptojë më mirë detyrat e tij gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Kavajë, të datës 7 maj 2017.

Detyra juaj është të zbatoni Kodin Zgjedhor, vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së me profesionalizëm, etikë dhe standarde të larta, për të garantuar që çdo zgjedhës të ushtrojë lirisht të drejtën e votës së lirë, të fshehtë, të barabartë, të drejtëpërdrejtë.

Jeni ju ata, të cilët do të respektoni dhe garantoni mbarëvajtjen e procesit të votimit, sipas standardeve demokratike.

Ju urojmë punë të mbarë!

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Veprimtaria dhe vendimmarrja e Komisionit Qendror të Qendrës së Votimit dokumentohet/protokollohet/regjistrohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, në të cilin ju do të gjeni vendimet dhe procesverbalet, të miratuara nga KQZ, me të cilat do të punoni gjatë ditës së zgjedhjeve.

Kujtesë! Procesverbali i Vulosjes së kutisë së votimit [Model PV-KQV-07]
dhe Procesverbali për Mbylljen e Votimit [PV-KQV-08]
nuk gjenden në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, por
ato i gjeni në Manualin dhe Fletoren e punës së KQV-së.

Shkurtime të përdorura në Manual:

RSH	Republika e Shqipërisë
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KZAZ	Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor
KQV	Komisioni i Qendrës së Votimit
LPM	Libri i Protokollit të Mbledhjeve
VNV	Vendi i Numërimit të Votave
KZ	Kodi Zgjedhor
V	Vendim
U	Udhëzim

I. KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT

1. KQV-ja:



- ✓ Është organ kolegjal, përbëhet nga shtatë anëtarë, ku një anëtar ushtron detyrën e sekretarit. Anëtarët dhe sekretari i KQV-së emërohen nga KZAZ.
- ✓ Përgjigjet për zhvillimin e zgjedhjeve në Qendrën e Votimit, duke zbatuar detyrat e parashikura në Kodin Zgjedhor, në udhëzimet dhe vendimet e KQZ-së.
- ✓ Udhëhiqet nga parimet bazë të administrimit të një procesi zgjedhor, legjitimiteti, transparencë, paañësia, profesionalizmi, duke siguruar zhvillimin e zgjedhjeve demokratike në përputhje me standardet e kërkuara.

Kryetari dhe sekretari i KQV-së zgjidhen nga KZAZ-ja
Sekretari është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin.



1.1. Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së [n. 39 i KZ]

a. Shkarkimi i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së:

Anëtari dhe sekretari i KQV-së shkarkohen nga detyra me vendim të KZAZ-së kur:

- shkelin dispozitat e Kodit Zgjedhor ose të akteve nënligjore në zbatim të tij, lidhur me detyrat e KQV-së;
- dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- nuk paraqiten në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 (dy) ditë rresht; ose
- nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ.

Kujdes! Anëtari dhe sekretari i KQV-së, i shkarkuar nga detyra me vendim të KZAZ-së, nuk mund të rizgjidhet në këtë detyrë.

b. Lirimi i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së

Anëtarët dhe sekretari i KQV-së lirohen nga detyra me vendim të KZAZ-së kur:

- kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë zgjedhore për organet e qeverisjes vendore/deputet;
- janë në marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;
- japin dorëheqjen nga detyra;
- nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës.

1.2 Plotësimi i vakancës

Kur vendi i një anëtari ose sekretarit të KQV-së mbetet vakant, KQV njofton KZAZ-në. KZAZ-ja plotëson vakancat, si më poshtë:

- Vendi vakant i një anëtari [apo sekretari] plotësohet brenda 3 ditëve, por jo më vonë se 24 orë para hapjes së votimit.
- Zëvendësimi i anëtarëve të larguar në ditën e zgjedhjeve ose që nuk paraqiten në detyrë, bëhet jo më vonë se 2 orë nga njoftimi i mungesës.
- Kur KQV-ja mbetet pa kuorum, për shkak të mungesave të anëtarëve dhe me kalimin e afatit të përcaktuar në gërmat "a" dhe "b" KZAZ urdhëron vazhdimin e procedurave dhe merr masa për plotësimin kryesisht të vakancës.
- KZAZ për plotësimin e vakancës kryesisht, emëron shtetas të përzgjedhur nga KQZ-ja për emërimet kryesisht, deri në plotësimin e kuorumit në QV-në përkatëse.

KQZ i dërgon KZAZ-së listën e miratuar të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë apo sekretar të KQV-ve. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, emëron anëtarët apo sekretarin e KQV-së, sipas rastit për të plotësuar vendin vakant, me emrat nga kjo listë, duke i dhënë përparësi trajnimeve në fushën e zgjedhjeve, eksperiencave të mëparshme në administratën zgjedhore dhe kualifikimeve profesionale.

e. Dorëheqja e anëtarit të KQV-së

Kujdes! Kur anëtari i KQV-së jep dorëheqjen, deklarata e dorëheqjes depozitohet në KQV.

Sekretari bën shënimet përkatëse në LPM të KQV-së dhe menjëherë i dërgon njoftimin KZAZ-së lidhur me krijimin e vakancës. Anëtari i KQV-së i dorëhequr, nuk largohet nga KQV-ja, pa e dorëzuar detyrën tek zëvendësuesi i tij.

KUJDES!

Kryetari, sekretari ose dy anëtarë të KQV-së njoftojnë menjëherë KZAZ për vakancat, largimin, dorëheqjen ose mungesën.

2. Detyrat e Kryetarit të KQV-së

Detyra e Kryetarit	Koha e kryerjes
Detyra gjatë marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja:	Një ditë para ditës së zgjedhjeve:
<p>a</p> <p>Paraqitet në KZAZ bashkë me sekretarin, të shoqëruar nga çdo anëtar tjetër i cili kërkon të jetë i pranishëm, për të tërhequr materialet zgjedhore të KQV-së;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Merr në dorëzim materialet zgjedhore nga KZAZ-ja, së bashku me sekretarin e KQV-së; - Firmos procesverbalet: <ul style="list-style-type: none"> ✓ Model PV-KQV-05, "Për pajisjesn e KQV-së nga KZAZ me materiale zgjedhore"; ✓ Model PV-KZAZ-06, "Për pajisjen e KQV-së nga KZAZ me vula me kode sigurie për vulosjen e kutisë së votimit dhe kutisë së materialeve zgjedhore"; ✓ Procesverbalin e përgatitur nga KZAZ për marrjen në dorëzim të listës së zgjedhësve. - Sigurohet që Sekretari firmos dhe administron çdo kopje të procesverbaleve. 	<p>Në orën e përcaktuar nga KZAZ, dhe</p> <p>tërheqja e bazës materiale bëhet jo më vonë se ora 15⁰⁰ e datës 17.6.2017</p> <p>KZ neni 100</p> <p>U nr.2/2015, neni 12/ 2/a</p>
<p>b</p> <p>Merr në dorëzim vulën e kryetarit nga KZAZ-ja, në prani të anëtarëve të KZAZ-së, sipas procedurës të përcaktuar</p>	<p>Jo më vonë se ora 15⁰⁰ e datës 17.6.2017</p> <p>KZ, neni 100/2;</p> <p>U nr.2/2015, neni 12/ 2/b</p>
<p>c</p> <p>Dërgon materialet zgjedhore në QV, bashkë me sekretarin e KQV-së, dhe çdo anëtar tjetër që ka shoqëruar tërheqjen e materialeve zgjedhore</p>	<p>Sapo i merr ato në dorëzim</p>
<p>ç</p> <p>Rregullon, organizon qendrën e votimit, së bashku me anëtarët e tjerë, tryezat, karriget dhe dhomat e fshehtësisë në mënyrë të tillë që të sigurohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - fshehtësia e votimit dhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve; si dhe - vëzhgimi i lirshëm i procesit të votimit nga vëzhguesit. 	<p>Me të mbërritur në QV</p>
<p>d</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sigurohet, për <ul style="list-style-type: none"> ✓ mbylljen e dritareve dhe derës, ✓ vulosjen e derës së QV-së me një simbol, të vendosur në plastelinë, të zgjedhur nga vetë, anëtarët e KQV-së, në prani të punonjësit të Policisë së Shtetit. - Njofton, menjëherë, KZAZ-në, në rast mosparaqitje të punonjësit të Policisë së Shtetit 	<p>Menjëherë pas rregullimit të QV-së</p>

Detyra para hapjes së procesit të votimit, në orën 6 ⁰⁰		
a	Paraqitet në Qendrën e Votimit	Në orën 6 ⁰⁰ , [një orë para hapjes së procesit të votimit] KZ neni 101/1
b	Kryetari, sekretari ose dy anëtarë të KQV-së njoftojnë menjëherë KZAZ-në: - nëse janë të pranishëm më pak se 4 anëtarë. Kujdes! Vonesa për kryerjen e njoftimit mund të bëhet shkak për pavlefshmëri të zgjedhjeve.	Në orën 6 ⁰⁰
c	Kontrollon, së bashku me anëtarët e tjerë të pranishëm, nëse vula në derën e QV-së, është e paprekur	Në orën 6 ⁰⁰
ç	Sigurohet se: Në QV, janë vetëm vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe të huaj.	Në orën 6 ⁰⁰
d	Drejton, së bashku me sekretarin, kryerjen nga anëtarët e KQV-së të veprimeve, paraprake, të mëposhtme: - Heqjen e materialeve propagandistike në QV dhe rreth saj, në distancë 150 m nga QV-ja; - Vendosjen e posterave, udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm brenda QV- së;	Në orën 6 ⁰⁰ KZ, neni 101/1/a, b, c, ç, d
dh	- Drejton, së bashku me sekretarin: Hapjen dhe kontrollin e materialeve zgjedhore sipas inventarizimit të tyre, procesverbaleve përkatëse;	Në orën 6 ⁰⁰ KZ, neni 101/1/ d
e	Drejton mbledhjen e parë të KQV-së për të marrë vendimin sipas Model-01V KQV "Për caktimin e detyrave të anëtarëve të KQV-së"	Sapo kryen veprimet e mësipërme
ë	- Sigurohet që të gjithë anëtarët e KQV-së firmosin vendimin, Model-01V KQV; - Firmos vendimin e KQV-së, Model-01V KQV	Menjëherë pas marrjes së vendimit
f	Drejton, së bashku me sekretarin, kryerjen e veprimeve, paraprake të KQV-së, për kryerjen e procedurave për hapjen e votimit; - Vulosjen e kutisë së votimit sipas procedurës; ✓ Sigurohet që në LPM dhe Procesverbalin e Vulosjes së kutisë së votimit, PV-KQV-07, Sekretari ka plotësuar të gjitha të dhënat dhe orën e plotësimit të procesverbalit	Menjëherë pas vulosjes së vendimit Model-01V KQV KZ, neni 101/1/dh, e U nr.2/2015, neni 12/ 2/c

g	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Vulos (mbyll) kutinë e votimit me vulat me kodet e sigurisë, në mënyrë të tillë që të mos lejojë hapësira mes kutisë dhe kapakut të saj; ✓ Sigurohet që vulosja e kutisë së votimit me vulat me kodet e sigurisë të bëhet në mënyrë të tillë, që të mos lejojë hapësira mes kutisë dhe kapakut të saj. 	Menjëherë, pas plotësimit të PV-KQV-07 KZ, neni 101/1/e
gj	<ul style="list-style-type: none"> - Sigurohet që anëtarët e KQV-së firmosin në LPM dhe Procesverbalin e Vulosjes së kutisë së votimit, Model PV- KQV-07; - Firmos në LPM dhe Model PV- KQV-07 	Menjëherë, pas nënshkrimit të PV-KQV-07 nga anëtarët e tjerë
h	<p>Sigurohet që Sekretari ka kryer veprimet e nevojshme për mbylljen e Procesverbalit Model PV- KQV-07 në dy zarfa të etiketuar "ZARFI I PROCESVERBALIT TË VULOSJES", model Z.01 dhe futjen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Kutinë e Votimit, të zarfit me procesverbalin [origjinal] MODEL PV- KQV-07; ✓ Kutinë e Materialeve Zgjedhore, të zarfit tjetër me procesverbalin [kopje] MODEL PV- KQV-07, para fillimit të procesit të votimit. 	Pas vulosjes së PV-KQV-07 nga Sekretari i KQV-së
i	<ul style="list-style-type: none"> - Drejton mbledhjen e KQV-së për marrjen e vendimit Model-02V KQV "Për hapjen e votimit"; - Firmos vendimin Model-02V KQV, pasi sigurohet që atë e kanë firmosur anëtarët e KQV-së. 	Pak para orës 7 ⁰⁰ , para hapjes së procesit të votimit
Detyra gjatë procesit të votimit		Nga ora 7 ⁰⁰ deri para mbylljes së votimit
a	Deklaron hapjen e votimit në QV;	Në orën 7 ⁰⁰ U nr.2/2015, neni 12/ 2/ç
b	<p>Merr dokumentin e identitetit të zgjedhësit;</p> <ul style="list-style-type: none"> -Kontrollon/gjen emrin e zgjedhësit në listën e zgjedhësve; -Verifikon nëse të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit; -Shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë të dokumentit të identitetit [në kolonën "Numri i dokumentit të identifikimit"], kur të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen dhe - i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë 	Sapo zgjedhësi paraqitet në QV për të votuar KZ, neni 105, pika 1/c U nr.2/2015, neni 12/ 2/d
c	Orienton zgjedhësin të nënshkruajë në listën e zgjedhësve anash emrit të tij	Pas verifikimit të të dhënave të zgjedhësit dhe kryerjes së veprimeve në listën e zgjedhësve
ç	Vulos fletët e votimit në pjesën e pasme me vulën e Kryetarit të KQV-së	Para se t'i jepet zgjedhësit U nr.2/ 2015, neni 12, pika 2/dh

d	<p>Kur largohet nga QV-ja, i kalon për përdorim anëtarit tjetër me të njëjtën përkatësi politike deri në çastin e rikthimit të tij:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vulën e kryetarit, - Listën e Zgjedhësve, - Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve, - Zarkin me fletët e votimit të dëmtuara. 	<p>Gjatë procesit të votimit</p> <p>U nr.2/2015, neni 12, pika 2/e</p>
dh	<p>Nëse zgjedhësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bën shënimin në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtësisë, - Bën shënimin ose dëmton fletën e votimit padashje, - Fotografon fletën e votimit, pasi ka bërë shënimin; <p>Kujtesë! Në të tri rastet e mësipërme, zgjedhësi nuk lejohet të hedh fletën e votimit në kutinë e votimit dhe</p> <p>Kryetari:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ I merr zgjedhësit fletën e votimit, ✓ Shënon në pjesën e pasme fjalën "E DËMTUAR"; ✓ E fut këtë fletë votimit në zarkin e etiketuar, model Z.02, "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA"; dhe <ul style="list-style-type: none"> - Urdhëron sekretarin t'i japë këtij zgjedhësi një fletë votimi të dytë. <p>Kujdes! Nëse zgjedhësi përsërit, të njëjtin veprim si në tri rastet e mësipërme, edhe në fletën e dytë të votimit, Kryetari</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shënon në pjesën e pasme të fletës së votimit "E DËMTUAR" dhe e fut fletën e dytë të votimit, në zarkin model Z.02. - Urdhëron Sekretarin të mos i japë më fletë tjetër votimi këtij zgjedhësi. - Sigurohet që sekretari zbatoi urdhërin. 	<p>Menjëherë, pas kryerjes së veprimit të përshkruar në të tri rastet</p> <p>U nr.2/2015, neni 12, 2/ ë</p>
e	<ul style="list-style-type: none"> - Njofton menjëherë KZAZ-në për incidente të ndodhura që rrezikojnë rendin dhe zhvillimin e rregullt të votimit; - Sigurohet që Sekretari i dokumenton ato në LPM dhe plotëson procesverbalet dhe vendimet përkatëse për rastet ndërprerjes, pezullimit dhe rifillimit të votimit 	<p>Në çdo kohë</p> <p>U nr.2/2015, neni 12, pika 2/g</p>
ë	<ul style="list-style-type: none"> -Shënon në Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve: <ul style="list-style-type: none"> ➤ të dhënat identifikuese <ul style="list-style-type: none"> ✓ të zgjedhësit që voton me vendim Gjykate; ✓ anëtarit të KZAZ-së, dhe [sipas rastit] ➤ Numrin, datën e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ose ➤ Numrin, datën e vendimit të KZAZ-së; - Bashkëlidh [sipas rastit] vendimin e Gjykatës ose vendimin dhe vërtetimin e KZAZ-së 	<p>Para se të votojë zgjedhësi i pajisur me</p> <ul style="list-style-type: none"> - vendim Gjykate apo - vendim të KZAZ-së
f	<p>Sigurohet nëse ka zgjedhës në radhë për të votuar</p>	<p>Në ora 19⁰⁰</p>

g	Cakton, së bashku me Sekretarin, dy anëtarë të KQV-së, pozitivë opozitivë, për të mbledhur dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve që janë të pranishëm në radhë, për të votuar	Në orën 19 ⁰⁰ , pasi njoftohet nga anëtarë që mban rregullin [radhën]
gj	Shënon të dhënat identifikuese të anëtarit të KQV-së, në Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve, në kolonën ku është shkruar: - Numri dhe data e vendimit të Gjykatës ose - Numri dhe data e vendimit të KZAZ-së TË DHËNAT IDENTIFIKUESE, PËR ÇDO ZGJEDHËS, NË REGJISTËR, DUHET TË PLOTËSOHEN SAKTËSI SHT DHE ME GËRMA TË MËDHA	Përpara mbylljes së votimit, pasi ka votuar edhe zgjedhësi i fundit, i pranishëm në radhë në ora 19 ⁰⁰
Detyra në mbyllje dhe pas mbylljes së procesit të votimit		
a	- Bën shënimin në Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve: Ky regjistër mbyllet me numër rendor, [me shifër dhe me fjalë: numri i zgjedhësve të shënuar në të] - Firmos Regjistrin.	Në mbyllje të procesit të votimit, pasi ka votuar edhe zgjedhësi i fundit, i pranishëm në radhë [edhe anëtarët e KQV-së]
b	Njofton Komisaratin e Policisë së Shtetit dhe KZAZ-në për të dërguar në QV punonjës të Policisë së Shtetit, për shoqërimin e kutisë së votimit me fletët e votimit dhe kutisë së materialeve të votimit.	Pas mbylljes së votimit
c	- Drejton mbledhjen për mbylljen e votimit, - Sigurohet që Sekretari plotëson vendimin "Për mbylljen e votimit" dhe shënon orën e saktë të mbylljes së tij; - Firmos vendimin e KQV-së MODEL-07 V KQV "Për mbylljen e votimit" dhe LPM-në, pasi sigurohet që i kanë firmosur ato anëtarët e KQV-së	Pasi voton zgjedhësi i fundit, i pranishëm [edhe anëtarët e KQV-së]
ç	Sigurohet se: Në QV qëndrojnë vetëm anëtarët e KQV-së, vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe të huaj si dhe përfaqësuesit e akredituar të medias.	
d	Numëron, shënon dhe llogarit, së bashku me anëtarët e tjerë, zgjedhësit që kanë votuar, bazuar në nënshkrimet e bëra në: - Listën e zgjedhësve, dhe - Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve	Pas mbylljes së votimit KZ, neni 57 U nr.2/2015, neni 12, pika 2/g
dh	I deklaron me zë të lartë anëtarëve të tjerë të KQV-së dhe vëzhguesve të pranishëm shifrën e zgjedhësve që kanë votuar	Pas mbylljes së votimit U nr.2/2015, neni 12/ 2/gj
e	Fton anëtarët e KQV-së dhe vëzhguesit e pranishëm të verifikojnë shifrën e thënë prej tij	Pas mbylljes së votimit U nr. 2/2015, neni 12/ 2/h

ë	<p>Sigurohet, në rast se ka kundërshtime për përcaktimin e numrit të zgjedhësve që kanë votuar, që Sekretari</p> <ul style="list-style-type: none"> - bën shënimet në: <ul style="list-style-type: none"> ✓ PV-KQV-08 dhe LPM, nëse ka vërejtje nga anëtarët.; ✓ LPM, nëse ka vërejtje nga vëzhguesit; - plotëson vendimin Model-08V KQV, "Për përcaktimin e numrit të zgjedhësve, që kanë votuar" dhe - Sigurohet , që Sekretari i KQV-së i administroi dhe i futi në Kutinë e Materialeve të Votimit, Vërejtjet me shkrim nga vëzhguesit, së bashku me dokumentacionin tjetër të QV-së [LPM, etj.], sipas radhës në Etiketën "Kujtesë". 	<p>Pas mbylljes së votimit</p> <p>Pas numërimit të zgjedhësve në Listën e Zgjedhësve dhe Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve</p>
f	<p>Sigurohet, që Sekretari ka transmetuar në KZAZ -mbylljen e votimit,</p> <ul style="list-style-type: none"> -numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar -numrin e përgjithshëm të femrave. 	<p>Pas mbylljes së votimit</p>
g	<p>Urdhëron sekretarin e KQV-së të shënojë në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit, PV-KQV-08, dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së numrin e zgjedhësve, që kanë votuar në qendrën e votimit</p>	<p>Pas mbylljes së votimit</p> <p>U nr. 2/2015, neni 12/ 2/i</p>
gj	<p>Pasqyron në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, numrin e plotë të fletëve të votimit të qendrës së votimit, duke u bazuar tek të dhënat që kanë shoqëruar marrjen në dorëzim të fletëve të votimit nga KZAZ-ja, sipas Procesverbalit PV-KQV-05</p>	<p>Pas mbylljes së votimit</p> <p>U nr.2/ 2015, neni 12/ 2/j</p>
h	<p>Numëron fletët e votimit të papërdorura dhe në përfundim të numërimit ia bën të ditur shifrën anëtarëve të KQV-së</p>	<p>Pas kryerjes së veprimeve të mësipërme</p> <p>U nr.2/2015, neni 12/ 2/k</p>
i	<p>Rinumëron edhe një herë fletët e votimit të papërdorura</p>	<p>Nëse kërkohet nga një anëtar i KQV-së ose ndonjë nga vëzhguesit</p> <p>U nr. 2/2015, neni 12/ 2/l</p>
j	<p>Në përfundim të numërimit, mbyll fletët e votimit të papërdorura në zarfin e etiketuar "FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA"</p>	<p>U nr.2/2015, neni 12/ 2/ll</p>
k	<p>Numëron fletët e votimit të dëmtuara që gjenden në zarfin "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA" dhe i mbyll ato në zarf.</p>	<p>U nr.2/2015, neni 12/ 2/m</p>

I	Urdhëron Sekretarin të shënojë paraprakisht në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit, PV-KQV-08, numrat e kodeve të vulave të sigurisë me të cilat do të mbyllet - kutia e votimit me fletët e votimit dhe - kutia e materialeve të votimit	Sapo kryen veprimet e mësipërme U nr.2/2015, neni 12/ 2/n
II	Sigurohet që në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit, PV-KQV-08, janë plotësuar të gjitha të dhënat, [edhe numri i përgjithshëm i femrave, që kanë votuar] dhe ora e mbylljes së procesverbalit	U nr.2/2015, neni 12/ 2/nj
m	Sigurohet që Procesverbali për Mbylljen e Votimit PV-KQV-08 futet në: - kutinë e votimit, origjinali [PV-KQV-08], dhe - kutinë e materialeve të votimit, kopja [PV-KQV-08]	U nr.2/2015, neni 12/2/o
n	Vulos kutinë e votimit me fletët e votimit me vulën e fundit [të pestë], me kod sigurie, me ngjyrë zezë në hapësirën ku hidhet fleta e votimit	U nr.2/2015, neni 12/ 2/p
nj	-Sigurohet që në kutinë e materialeve të votimit u futën të gjitha materialet e votimit, sipas përshkrimit në etiketën "KUJTESË" në kapakun e kutisë së materialeve të votimit! -Sigurohet që Kutia e materialeve të votimit u vulos [mbyll] me katër vula me kode sigurie.	
o	- Dorëzon, së bashku me Sekretarin e KQV-së, me procesverbal Model PV-KZAZ-09, në KZAZ, VNV: ✓ kutinë e votimit me fletët e votimit dhe ✓ kutinë e materialeve të votimit. -Sigurohet, që procesverbalin Model PV-KZAZ-09 e firmosën jo vetëm ata [kryetari dhe sekretari KQV-së], dy anëtarët e KZAZ-së [pozitë-opozitë], por edhe punonjësi i Policisë, që i shoqëroi gjatë transportit, -Sigurohet, që sekretari i KQV-së merr dhe administron kopjen e këtij procesverbali.	Jo më vonë se ora 22 ⁰⁰ U nr.2/2015, neni 12/2/q

Kujdes!

Kryetari i KQV-së:

- ✓ drejton veprimet e KQV-së;
- ✓ drejton mbledhjet e KQV-së;
- ✓ i jep udhëzime sekretarit të KQV-së, për materialet për mbledhjen e KQV- së dhe shpërndarjen e tyre anëtarëve;
- ✓ firmos çdo faqe të LPM.

Kryetari i KQV-së vulos vetëm fletën e votimit, që i jepet zgjedhësit

3. Detyrat e sekretarit të KQV-së

Detyrat e sekretarit		Koha e kryerjes
Gjatë gjithë kohës së funksionimit të KQV-së		
a	Përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KQV-së	U nr.2/2015, neni 12/4/a
b	Protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KQV-së	U nr.2/2015, neni 12/4/b
c	Mban dokumentacionin zgjedhor të arkivuar	U nr.2/2015, neni 12/4/c
ç	Administron dhe është përgjegjës për mbajtjen e vulës së KQV-së	Kodi Zgjedhor, neni 103 Kodi Penal 326/a
d	Përgatit në përputhje me udhëzimet e kryetarit, materialet për mbledhjen e KQV-së dhe ua shpërndan ato anëtarëve	U nr.2/2015, neni 12/4/ç
dh	Mban procesverbalet e mbledhjeve të KQV-së	U nr.2/2015, neni 12/4/d
e	Kryen zbardhjen e vendimeve të marra nga KQV-ja dhe i vulos ato	U nr.2/2015, neni 12/4/dh
ë	Regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së vendimet e KQV-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara	U nr.2/2015, neni 12/4/e
f	U jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vertetuara të vendimeve të KQV-së dhe të procesverbaleve të mbledhjeve	U nr.2/2015, neni 12/4/ë
g	Regjistron në LPM: <ul style="list-style-type: none"> • të gjitha veprimet që kryen KQV-ja; • vërejtjet që vëzhguesit i paraqesin KQV-së; Firmos dhe vulos çdo faqe të LPM-së	U nr.2/2015, neni 12/4/f
Detyra gjatë marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KZAZ		Një ditë para ditës së zgjedhjeve
a	Paraqitet në KZAZ, bashkë me kryetarin e KQV-së, për tërheqjen e bazës materiale zgjedhore të KQV-së, të shoqëruar nga çdo anëtar që kërkon të jetë i pranishëm; Firmos procesverbalet: - Model PV-KQV-05, "Për pajisjesn e KQV-së nga KZAZ me materiale zgjedhore"; - Model PV-KZAZ-06, "Për pajisjen e KQV-së nga KZAZ me vula me kode sigurie për vulosjen e kutisë së votimit dhe kutisë së materialeve zgjedhore"; - Procesverbalin e përgatitur nga KZAZ për marrjen në dorëzim të listës së zgjedhësve	Në orën e përcaktuar nga KZAZ, dhe tërheqja e bazës materiale bëhet jo më vonë se ora 15 ⁰⁰ e datës 17.6.2017 KZ neni 100 U nr.2/2015, neni 12/ 2/a
b	Depoziton numrin e celularit në KZAZ	Gjatë tërheqjes së bazës materiale zgjedhore

c	Dërgon materialet zgjedhore në QV, së bashku me kryetarin e KQV-së dhe çdo anëtar tjetër që ka shoqëruar tërheqjen e materialeve zgjedhore	Sapo i merr ato në dorëzim
ç	- Regjistron në LPM marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja, sipas inventarit përkatës; dhe - Përgjigjet për administrimin dhe ruajtjen e tyre në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor	KZ, neni 100 U nr.2/2015, neni 12/4/f
d	Rregullon/sistemon, së bashku me anëtarët e tjerë që janë të pranishëm, pajisjet e domosdoshme për QV-në si: tavolinat, karriget, dhe nëse mungojnë, njofton KZAZ-në;	Me të mbërritur në QV
dh	Siguron, bashkë me anëtarët e tjerë të KQV-së, në kohën e largimit nga QV-ja për: - mbylljen e dritareve dhe derës, - vulosjen e derës së QV-së, me një symbol, të vendosur në plastelinë, të zgjedhur nga vetë, anëtarët e KQV-së, në prani të punonjësit të Policisë së Shtetit, i ngarkuar me shërbim në këtë QV.	Menjëherë, pas rregullimit të QV-së
Detyra përpara hapjes së procesit të votimit, në orën 6 ⁰⁰		
a	Paraqitet në QV	Në orën 6 ⁰⁰ KZ, neni 101/1
b	Kontrollon , së bashku me anëtarët e tjerë, vulën e derës së QV-së, nëse është e paprekur	Në orën 6 ⁰⁰
c	Njofton KZAZ-në për: - praninë e anëtarëve të KQV-së [numrin e anëtarëve dhe nëse janë të pranishëm më pak se 4, katër]; Kujdes! Vonesa për kryerjen e njoftimit mund të bëhet shkak për pavlefshmëri të zgjedhjeve. - Hapjen e Qendrës së Votimit	Në orën 6 ⁰⁰ KZ, neni 36/4
ç	U kontrollon vëzhguesve shqiptarë dhe të huaj - dokumentin e akreditimit, me të cilin i ka pajisur KZAZ/KQZ-ja, dhe - dokumentin e identifikimit të vlefshëm [letër njoftimi/kartë identiteti ose pasaportë];	Në orën 6 ⁰⁰
d	Kryen veprimet paraprake për hapjen e votimit së bashku me Kryetarin, në prani të vëzhguesve	Në orën 6 ⁰⁰ KZ, neni 101/1
dh	- Heq, bashkë me anëtarët e tjerë të KQV-së, materialet propagandistike në QV dhe rreth saj, në distancë 150 m nga QV-ja; - Vendos, bashkë me anëtarët e tjerë të KQV-së, posterat, udhëzimet për kryerjen e votimit;	Në orën 6 ⁰⁰

e	<p>- Hap dhe kontrollon materialet zgjedhore sipas inventarizimit të tyre, duke u bazuar në procesverbalet përkatëse për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ pajisjen e KQV-së me materiale zgjedhore nga KZAZ-ja, model PV-KQV-05; ➤ pajisjen e KQV-së me vula me kode sigurie, model PV-KZAZ-06; ➤ dorëzimin nga KZAZ-ja të listës së zgjedhësve të QV-së; <p>- Shënon në LPM, nëse materialet zgjedhore përputhen me procesverbalet, dhe</p> <p>- Njofton menjëherë KZAZ-në, nëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ mungon ndonjë nga materialet zgjedhore; apo ➤ ka mosdakortësi për marrjen e vendimit "Për caktimin e detyrave" apo ➤ vazhdimin e kryerjes së procedurave për hapjen e votimit 	Në orën 6 ⁰⁰
ë	<p>- Sigurohet që KQV të bëjë mbledhjen e parë dhe të marrë vendimin për caktimin e detyrave të anëtarëve të KQV-së;</p> <p>- Regjistron/Shënon në LPM:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Vendimin për caktimin e detyrave të anëtarëve të KQV-së, sipas Model 01V KQV; <p>- Plotëson vendimin e KQV-së, Model-01V KQV</p>	Pasi ka kryer veprimet e mësipërme
	<p>Sigurohet që anëtarët e KQV-së, nën drejtimin e Kryetarit, të kryejnë procedurat e vulosjes [mbylljes] së kutisë së votimit, me katër vula me kode sigurie, me ngjyrë të zezë [hapësira e kapakut të kutisë së votimit, ku hidhet fleta e votimit, nuk vulozet]</p>	Pasi është marrë, plotësuar, firmosur dhe vulosur vendimi i KQV-së, Model-01V KQV
f	<p>- Shënon, paraprakisht, në: Procesverbalin e Vulosjes së kutisë së votimit, Model PV-KQV-07 dhe në LPM,</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Numrat [gjashtëshifror] të kodeve të çdo vule të sigurisë [me ngjyrë zezë]; <p>Kujdes! Shënoni në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe në Procesverbalin e Vulosjes, Model PV-KQV-07, edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Numrin [gjashtëshifror] të kodit të sigurisë të vulës së dëmtuar, me ngjyrë të zezë, në rast se ndodh gjatë mbylljes së kutisë së votimit; ✓ Numrin [gjashtëshifror] të kodit të vulës rezervë të sigurisë me ngjyrë të bardhë, me të cilën zëvendësohet vula e dëmtuar; <p>- Zëvendëson me vulën rezervë të sigurisë, me ngjyrë të bardhë, vulën e dëmtuar, e cila u shënua në LPM dhe PV-KQV-07.</p>	Para hapjes së procesit të votimit

g	<p>-Plotëson procesverbalin e vulosjes së kutisë së votimit Model PV-KQV-07;</p> <p>-Firmos dhe Vulos Procesverbalin, Model PV-KQV-07 [edhe kopjet e tij], pasi në të kanë nënshkruar të gjithë anëtarët e KQV-së, edhe në LPM;</p> <p>-Sigurohet që në LPM dhe Procesverbalin e Vulosjes së kutisë së votimit, PV-KQV-07, janë plotësuar të gjitha të dhënat dhe ora e plotësimit të procesverbalit</p>	<p>Para hapjes së procesit të votimit</p> <p>KZ, neni 101/ 1/e</p>
gj	<p>Mbyll në dy zarfa të etiketuar, "ZARFI I PROCESVERBALIT TË VULOSJES", model Z.01:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ origjinalin e procesverbalit Model PV-KQV-07, në një zarf, model Z.01; ✓ kopjen e procesverbalit Model PV-KQV-07, në zarfin tjetër, model Z.01 	<p>Menjëherë pas plotësimit të PV-KQV-07</p> <p>KZ, neni 101/ 1/e</p>
h	<p>Sigurohet që vulosja e kutisë së votimit me vulat me kodet e sigurisë të bëhet në mënyrë të tillë, që të mos lejojë hapësira mes kutisë dhe kapakut të saj</p>	<p>Menjëherë pas plotësimit të PV-KQV-07</p>
i	<p>Fut në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kutinë e Votimit , zarfin me procesverbalin [origjinalin] MODEL PV-KQV-07 ; - Kutinë e Materialeve Zgjedhore, Zarfin tjetër me procesverbalin [kopje] MODEL PV-KQV-07 , para fillimit të procesit të votimit. 	<p>Pas kryerjes së veprimeve të mësipërme</p>
j	<p>Sigurohet që :</p> <ul style="list-style-type: none"> - origjinali i procesverbalit Model PV-KQV-07, i vendosur në zarfin, model Z.01, është futur në Kutinë e Votimit; - kopja e procesverbalit Model PV-KQV-07, e vendosur në një zarf tjetër, model Z.01, është futur në Kutinë e materialeve të Votimit 	<p>Para hapjes së procesit të votimit</p>
k	<p>Sigurohet që i kryeu veprimet e mësipërme me Procesverbalin e Vulosjes së kutisë së votimit, Model PV- KQV-07 dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> - I regjistroi ato në LPM 	<p>Para hapjes së procesit të votimit</p> <p>KZ, neni 101/ 1/e</p>
l	<p>U jep subjekteve zgjedhore dhe vëzhguesve të akredituar, kopje të vërtetuara, të Procesverbalit Model PV- KQV-07, nëse e kërkojnë.</p>	<p>Në kohën e vulosjes së kutisë së votimit me vula me kode sigurie, para fillimit të votimit</p> <p>Kur ka kërkesa të tilla</p>
ll	<ul style="list-style-type: none"> - Plotëson vendimin për hapjen e votimit, Model-02V KQV, edhe orën e saktë të plotësimit të tij; - Firmos dhe vulos vendimin, Model-02V KQV, pasi e kanë nënshkruar anëtarët e tjerë 	<p>Pak para orës 7⁰⁰, para hapjes së procesit të votimit;</p> <p>KZ, neni 101/ 2</p>

Detyra gjatë procesit të votimit		Nga ora 7 ⁰⁰ deri para mbylljes së votimit
a	Njofton, menjëherë, KZAZ-në për: - fillimin e procesit të votimit, orën e saktë të hapjes së votimit; - numrin e anëtarëve të KQV-së prezent; - në rast të hapjes së votimit përtej orës së përcaktuar me ligj, njofton arsyen e vonesës dhe orën e fillimit të votimit;	Në orën 7 ⁰⁰ V nr.13/2015 U 2/2015, neni12/4/k
b	Njofton KZAZ-në për: plotësimin e vendeve vakant, të krijuara në KQV	Sapo plotësohet vakanca
c	Shënon në LPM: - kohën e largimit të kryetarit nga QV dhe emrin e anëtarit të KQV-së, me të njëjtën përkatësi politike, i cili do të administrojë vulën e Kryetarit të KQV-së, listën e zgjedhësve, Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve dhe Zarin me fletët e votimit të dëmtuara, deri në rikthimin e tij; - kohën e largimit të tij nga QV dhe emrin e anëtarit të KQV-së, me të njëjtën përkatësi politike, i cili do të administrojë LPM, vulën e KQV-së dhe fletët e votimit deri në rikthimin e tij; - kohën e largimit të anëtarit nga QV, që kontrollon duart e zgjedhësit nëse janë të timbrosura dhe emrin e anëtarit të KQV-së, me të njëjtën përkatësi politike, i cili do të kryejë këtë detyrë, deri në rikthimin e tij; Kujtesë! E njëjta procedurë kryhet edhe për detyrat e anëtarëve të tjerë: Timbruesit, Orientuesit për hedhjen e fletës së votimit në kutinë e votimit, Ruajtësit të radhës [rregullit]	Gjatë procesit të votimit, Në orën e - largimit - kthimit të çdo anëtarit nga QV KZ, neni 102/2
ç	Vulos fletën e votimit	KZ, neni 105, pika 1/d
d	I jep zgjedhësit fletën e votimit	Pasi e ka vulosur këtë fletë votimi edhe kryetari i KQV-së
dh	Njofton KZAZ-në për : - numrin e zgjedhësve që kanë votuar;	Çdo tre orë pas orës së hapjes së votimit, në: ora 10 ⁰⁰ ora 13 ⁰⁰ ora 16 ⁰⁰
e	- I jep deklaratën [e cila ndodhet në LPM] zgjedhësit, që do të ndihmojë një zgjedhës, i cili për arsye fizike nuk mund të votojë vetë; dhe - I shpjegon atij procedurën e plotësimit të kësaj deklarate	Gjatë procesit të votimit, kur paraqitet zgjedhësi PAK KZ neni 108
ë	Regjistron/shënon në LPM: - emrin e zgjedhësit, kur ai paraqitet në QV i timbrosuar, dhe mosdhënien e fletës së votimit [nuk i jep fletë votimi zgjedhësit]; - emrin e zgjedhësit, kur ai nuk pranon të timbrosset dhe zgjedhësi nuk lejohet të votojë;	Gjatë procesit të votimit [sipas rastit] KZ, neni 105

f	<p>Regjistron/shënon në LPM: rastet e dëmtimit të fletës së votimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - emrin e zgjedhësit, kur ai <ul style="list-style-type: none"> ✓ bën shënimin në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtësisë ose ✓ dëmton padashje apo e fotografon fletën e votimit, dhe - dhënien e një flete votimi të dytë këtij zgjedhësi [në këto raste i jep zgjedhësit një fletë votimi të dytë]; <p>Kujdes! Nëse zgjedhësi përsërit, të njëjtin veprim si në tri rastet e mësipërme, Sekretari nuk i jep më fletë votimi këtij zgjedhësi.</p>	<p>Gjatë procesit të votimit, [sipas rastit]</p> <p>KZ, neni 109</p>
g	<ul style="list-style-type: none"> - Shënon në Librin e Protokollit të Mbledhjeve (LPM) të KQV-së <ul style="list-style-type: none"> ✓ rastet e ndërprerjes apo pezullimit të votimit, ✓ orën dhe shkaqet e ndërprerjes apo pezullimit të votimit; - Njofton menjëherë KZAZ-në 	<p>Sapo ndërpritet procesi i votimit në QV</p> <p>V nr.13/2015 U 2, neni 12/4/i</p>
gj	<p>Plotëson procesverbalet dhe vendimet përkatëse për rastet ndërprerjes, pezullimit dhe rifillimit të votimit</p>	<p>Sapo ndërpritet, pezollohet apo rifillon procesi i votimit në QV</p>
h	<p>Shënon në LPM orën e rifillimit të votimit dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> - njofton menjëherë KZAZ-në 	<p>Në kohën e marrjes së vendimit për rifillimin e votimit në QV</p>
i	<p>Dokumenton, regjistron në LPM,</p> <ul style="list-style-type: none"> - rrethanat e dëmtimit, humbjes apo nxjerrjes Jashtë ambientit të QV-së të vulës së kryetarit apo të KQV-së; - orën e nxjerrjes nga përdorimi, për shkak të dëmtimit, etj. të një nga vulat; - orën e njoftimit të KZAZ-së për rastin, e mësipërm; ✓ marrjen në dorëzim të vulës rezervë të KQV-së apo të kryetarit të KQV-së nga KZAZ [dy anëtarë të saj, pozitë-opozitë ose punonjës i KQZ-së] me procesverbal PV-2/Vulë Rezervë; ✓ orën e zëvendësimit me vulën rezervë të vulës së nxjerrë nga përdorimi; <p>Firmos PV-2/Vulë Rezervë, pasi ka nënshkruar kryetari KQV-së</p>	<p>KZ, neni 103</p>
j	<p>Regjistron në LPM,</p> <ul style="list-style-type: none"> - pas kalimit të afateve për plotësimin e vakancave, dhe - rastet kur KZAZ-ja urdhëron me vendim KQV-në për vazhdim të procedurave nën kuorum 	<p>Jo më vonë se 2 orë nga njoftimi i largimit ose mungesës [vakancës]</p> <p>KZ, neni 36/4, 5</p>
k	<p>Njofton KZAZ-në për: çdo situatë problematike, menaxhimin dhe zgjidhjen e saj</p>	<p>Në çdo kohë</p>

I	<p>Shënon në LPM:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emrin e zgjedhësit, i pajisur me vendim Gjykatë të Rrethit Gjyqësor; - Emrin e anëtarit të KZAZ-së, i pajisur me vendim nga KZAZ-ja dhe vërtetim nga Sekretari i KZAZ-së 	Para se zgjedhësi të votojë
II	<ul style="list-style-type: none"> - Cakton, së bashku me kryetarin e KQV-së, dy anëtarë të KQV-së, pozitivë opozitë, për të mbledhur dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve që janë të pranishëm në radhë, për të votuar. - Shënon në LPM emrat e dy anëtarëve të KQV-së, të propozuar nga Kryetari dhe Sekretari 	<p>Kur njoftohet, nga anëtari që mban rregullin, se ka zgjedhës në radhë</p> <p>Në orën 19⁰⁰</p>
m	- Njofton KZAZ-në, nëse disa zgjedhës vijnë në QV pas marrjes së dokumentit të identifikimit të zgjedhësve, që kanë qenë në radhë në ora 19 ⁰⁰ dhe debatojnë me KQV-në, duke u bërë shkak për ndërprerjen apo pezullimin e votimit të zgjedhësve, para mbylljes së votimit	<p>Pas orës 19⁰⁰, kur janë duke votuar zgjedhësit, që kanë qenë në radhë</p>
n	<p>Orienton dhe i shpjegon anëtarit të KQV-së, i cili nuk e ka emrin në listën e zgjedhësve të kësaj QV-je:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjë deklaratë në LPM, ku - të deklarojë që nuk ka votuar në asnjë QV tjetër dhe - të nënshkruajë këtë deklaratë, para se ai të votojë 	<p>Përpara mbylljes së votimit, pasi ka votuar edhe zgjedhësi i fundit, i pranishëm në radhë në ora 19⁰⁰</p>
Detyra në mbyllje dhe pas mbylljes së procesit të votimit		
a	<ul style="list-style-type: none"> - Plotëson vendimin “Për mbylljen e votimit”, sipas MODEL–07V KQV dhe shënon orën e saktë të mbylljes së tij, edhe në LPM; - Firmos dhe vulos vendimin MODEL–07V KQV, pasi e kanë nënshkruar anëtarët e tjerë 	<p>Pasi ka votuar edhe zgjedhësi i fundit, i pranishëm në radhë [edhe anëtarët e KQV-së]</p> <p>KZ, neni 112/ 2 U nr.2/2015</p>

b	<p>Shënon në LPM edhe në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, Model PV-KQV-08:</p> <ul style="list-style-type: none"> - numrin e përgjithshëm të zgjedhësve, që kanë votuar, sipas nënshkrimeve të bëra në listën e zgjedhësve dhe në Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve; - numrin e përgjithshëm të femrave, që kanë votuar, - numrin e plotë të fletëve të votimit të QV-së, duke u bazuar tek të dhënat e Procesverbalit PV-KQV-05 - numrin e fletëve të votimit të papërdorura; - numrin e fletëve të votimit të dëmtuara; - pretendimet dhe vërejtjet e anëtarëve të KQV-së, nëse ka [shënohen në LPM dhe PV-KQV-08]; - vërejtjet e vëzhguesve, nëse ka [shënohen në LPM]; - numrin [gjashtëshifrorë] të kodit të vulës së fundit [së pestë] të sigurisë të Kutisë së Votimit me fletët e votimit; - numrat [gjashtëshifrorë] të kodeve të vulave të sigurisë të Kutisë së Materialeve Zgjedhore 	<p>Pas mbylljes së votimit</p> <p>V nr.13/2015</p>
c	<p>Vulos Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, Model PV-KQV-08, pas nënshkrimit nga anëtarët e tjerë; U jep subjekteve zgjedhore dhe vëzhguesve të akredituar, kopje të vërtetuara, të Procesverbalit Model PV-KQV-08</p>	<p>Pas plotësimit të gjithë rubrikave të tij dhe nënshkrimit nga anëtarët e tjerë dhe nëse i kërkojnë</p>
ç	<p>Në njoftimin e fundit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - i transmeton KZAZ-së: ✓ numrin e përgjithshëm të zgjedhësve, që kanë votuar në atë QV; ✓ numrin e përgjithshëm të femrave, që kanë votuar; - shënon shifrat e mësipërme në: ✓ Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, PV-KQV-08 dhe në LPM 	<p>Pas përcaktimit të numrit të zgjedhësve që kanë votuar</p>
d	<ul style="list-style-type: none"> - Mbyll në dy zarfa, Model Z.01, të etiketuar "ZARFI I PROCESVERBALIT TË VULOSJES SË KUTISË TË VOTIMIT", Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, PV-KQV-08 dhe - Fut në: ✓ Kutinë e votimit me fletët e votimit origjinalin [PV-KQV-08]; ✓ Kutinë e materialeve të votimit kopjen [PV-KQV-08] 	<p>KZ, neni 101/1/e</p>
dh	<p>Përgjigjet për vendosjen e materialeve zgjedhore në Kutinë e Materialeve të Votimit dhe vulosjen e saj me vulat me kodet e sigurisë;</p>	<p>KZ, neni 113/ 5, U nr. 2/2015, neni 12/4/gj</p>

e	<p>-Shoqëron, së bashku me kryetarin, anëtarët e tjerë të KQV-së, dhe punonjësën e Policisë së Shtetit,</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ kutinë e votimit me fletët e votimit, ✓ kutinë e materialeve të votimit në KZAZ; <p>-i dorëzon ato me procesverbal Model PV-KZAZ-09, në KZAZ, VNV.</p> <p>- Sigurohet, që procesverbalin Model PV-KZAZ-09 e firmosën jo vetëm ata [kryetari dhe sekretari KQV-së], dy anëtarët e KZAZ-së [pozitë-opozitë], por edhe punonjësi i Policisë, që i shoqëroi gjatë transportit,</p> <p>- merr dhe administron kopjen e këtij procesverbal.</p>	<p>Jo më vonë se 3 orë nga mbyllja e votimit KZ, neni 113/ 2</p>
---	--	--

4. Detyra të anëtarëve të KQV-së

Detyra të anëtarëve të KQV-së		Koha e kryerjes
Detyra përpara hapjes së procesit të votimit, në orën 6 ⁰⁰		
a	Paraqiten në QV përpara hapjes së votimit;	Në orën 6 ⁰⁰ , [një orë përpara hapjes së votimit] KZ, neni 101
b	Kontrollojnë vulën e derës së QV-së, nëse është e paprekur	Në orën 6 ⁰⁰
c	Heqin materialet propagandistike në QV dhe rreth saj, deri në një rreze prej 150 m;	Në orën 6 ⁰⁰ KZ, neni 101/1/b U nr. 2/2015, neni 12/3/c
ç	Vendosin posterat, udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm brenda qendrës së votimit	Në orën 6 ⁰⁰ KZ, neni 101/1/c
d	Vendosin tryezat, karriget dhe dhomat e fshehta në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit dhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve	Në orën 6 ⁰⁰ KZ, neni 101/1/a U nr. 2/2015, neni 12/3/ç
dh	Vendosin materiale të tjera të dërguara/kërkuara nga KQZ-ja	Në orën 6 ⁰⁰ KZ, neni 101/1/ç U nr. 2/2015, neni 12/3/d
e	Kontrollojnë të gjitha materialet zgjedhore të marra në dorëzim nga kryetari dhe sekretari, me procesverbalet përkatëse	Pas kryerjes së veprimeve të mësipërme KZ, neni 101/1/d U nr. 2/2015, neni 12/3/e

ë	Marrin vendim për caktimin e detyrave për secilin anëtar, sipas Model-01V KQV : - Ruajtjen e radhës së votimit të zgjedhësve; - Kontrollin e duarve të zgjedhësit, nëse është ose jo i timbruar me bojën posaçme; - Timbrimin me bojë të posaçme [të gishtit të madh të dorës së majtë] të zgjedhësit; - Orientimin e zgjedhësit për të hedhur fletën e votimit në kutinë e votimit.	Menjëherë, pas kontrollit dhe inventarizimit të materialeve zgjedhore V nr.46/2017
f	Nënshkruajnë në vendimin Model-01V KQV dhe Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së [LPM]	Menjëherë, pas plotësimit të Model-01V KQV dhe regjistrimit të tij në LPM nga Sekretari i KQV-së
g	U tregojnë vëzhguesve kutinë e votimit të zbrazët	KZ, neni 101/ 1/dh U nr. 2/2015, neni 12/3/ë
gj	Nënshkruajnë në - Procesverbalin e Vulosjes së Kutisë së Votimit, PV-KQV 07, dhe - Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, ku janë regjistruar numrat e kodeve të vulave të Sigurisë, me të cilat mbyllet kutia e votimit	Menjëherë, pas shënimit të numrave të kodeve të vulave të sigurisë KZ, neni 101/1/e U nr. 2/2015, neni 12/3/e
h	Marrin vendim për hapjen e votimit, dhe e nënshkruajnë atë, Model 02V-KQV	Pak para orës 7.00 [para hapjes së procesit të votimit]
Gjatë procesit të votimit		Nga ora 7⁰⁰ deri para mbylljes së votimit
a	Njoftojnë KZAZ-në për incidente që rrezikojnë rendin dhe zhvillimin e rregullt të votimit;	Kur ka raste të tilla KZ, neni 109/3/4 U nr. 2/2015, neni 12/3/h
b	Nënshkruajnë detyrimisht vendimet e KQV-së dhe procesverbalet që KQV-ja përdor në punën e saj;	U nr. 2/2015, neni 12/3/i
c	Kryejnë detyrën e ngarkuar sipas vendimit "Për caktimin e detyrave" Model-01V KQV, dhe detyrën e një anëtarit tjetër me të njëjtën përkatësi politike	Nga momenti i largimit deri në kthimin e anëtarit tjetër me të njëjtën përkatësi politike, kur KQV-ja i ngarkon edhe me detyrën tjetër
Detyra në mbyllje dhe pas mbylljes së procesit të votimit		
a	Vëzhgojnë procedurat pas mbylljes së Qendrës së Votimit dhe firmosin procesverbalin PV KQV-08 dhe LPM	KZ, neni 100

b	Shoqërojnë kryetarin dhe sekretarin e KQV-së për dorëzimin në KZAZ [vendin e numërimit të votave]: <ul style="list-style-type: none"> - kutisë së votimit me fletët e votimit dhe - kutinë e materialeve të votimit 	Ora 22 ⁰⁰ [Jo më vonë se tre orë nga mbyllja e votimit] KZ, neni 114
---	---	---

KUJDES:

Pjesëmarrja në trajnim është detyrim ligjor!
 Ju shkarkoheni nga detyra, në rast se nuk merrni pjesë në trajnim!
 [KZ, neni 39/1/ç]

5. MBLEDHJET DHE VENDIMET E KQV-SË



5.1 Mbledhjet e KQV-së

Mbledhjet e KQV-së janë publike.

Mbledhjet e KQV-së janë të vlefshme, kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të saj.

Mbledhjet e KQV-së pa kuorum janë të vlefshme, vetëm në rastet kur KZAZ-ja ka urdhëruar KQV-në me vendim përkatës të vazhdojë kryerjen e detyrave nën kuorum (KZ n.36/5).

Kujdes! Kur KQV-ja mbetet pa kuorum, për shkak të mungesave të anëtarëve dhe me kalimin e afatit, nuk është kryer zëvendësimi, KZAZ-ja urdhëron vazhdimin e procedurave dhe merr masa për plotësimin kryesisht të vakancës.

Vendimi i KZAZ-së është i detyrueshëm të zbatohet menjëherë nga KQV-ja.

KQV-ja e mbetur pa kuorum, bën shënimin përkatës në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe procedon me zbatimin e detyrave pas urdhërimit nga KZAZ-ja, pavarësisht nga kuorumi.

Shtetasi i emëruar nga KZAZ kryesisht si anëtar ose sekretar i KQV-së, ka të njëjtat të drejta dhe detyrime si anëtar apo sekretari i KQV-së, i propozuar nga partitë politike, parashikuar në Kodin Zgjedhor dhe Udhëzimin nr.2/2015.

5.2 Vendimet e KQV-së

Vendimet e KQV-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQV-së.

Vendimet e KQV-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim.

Secili prej anëtarëve, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën pro ose kundër, si dhe arsyetimin përkatës.

Kur KQV-ja, e urdhëruar nga KZAZ-ja kryen detyrat nën kuorum,
 vendimet e marra quhen të vlefshme.

KQV-ja gjatë punës së saj përdor modelet e vendimeve dhe dokumentacionin e punës të miratuar nga KQZ-ja.

5.3 KQV-ja merr vendime për:

- Caktimin/ndarjen e detyrave të anëtarëve të KQV-së në ditën e zgjedhjeve (MODEL–01V KQV);
- Hapjen e votimit (MODEL–02V KQV);
- Largimin e personave të caktuar nga mjediset e qendrës së votimit (MODEL–03V KQV);
- Pezullimin e votimit (MODEL–04V KQV);
- Kërkimin e ndihmës nga Policia e Shtetit për rivendosjen e rendit në qendrën e votimit (MODEL–05V KQV);
- Largimin nga qendra e votimit të forcave të Policisë së Shtetit pas rivendosjes së rendit në qendrën e votimit (MODEL–06V KQV);
- Mbylljen e votimit MODEL – 07V KQV, pasi kaloi ora 19⁰⁰ dhe ka votuar edhe zgjedhësi i fundit në radhë;
- Përcaktimin e numrit të personave që kanë votuar në qendrën e votimit sipas nënshkrimeve në listën e zgjedhësve dhe Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve (MODEL–08V KQV);
- Në rast se KQV-ja nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës çështja i dërgohet menjëherë për shqyrtim KZAZ-së nga kryetari ose nga të paktën dy anëtarë të KQV-së, ose mund të ankimohet në KZAZ nga subjekti i interesuar. Vendimi i KZAZ-së zbatohet nga KQV-ja.

KUJDES:

Vendimi “Për përcaktimin e numrit të personave që kanë votuar në qendrën e votimit”, MODEL–08V KQV, plotësohet vetëm në rastet kur ka kundërshtime për përcaktimin e shifrës së numrit të personave që kanë votuar në Qendrën e Votimit.

Të gjitha vendimet e marra nga KQV regjistrohen në LPM të KQV-së.

5.4 Modelet e dokumentacionit të punës:

- Model-01LP KQV: Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, në të cilin ndodhen modelet e vendimeve dhe procesverbaleve të KQV-së, si dhe Deklarata e personit që ndihmon një zgjedhës, sipas nenit 108 të Kodit Zgjedhor;
- Model-02R KQV: Regjistri i posaçëm i zgjedhësve që votojnë me vendim gjykatë.

5.4.1 Modelet e Procesverbaleve:

❖ Procesverbale për hapjen dhe mbylljen e votimit

- Model- PV-KQV-07 : Procesverbal për hapjen e votimit;
- Model- PV-KQV-08 : Procesverbal për mbylljen e votimit;

Kujdes!

- Procesverbali MODEL PV-KQV-07 plotësohet para hapjes së votimit, ndërsa
- Vendimi MODEL– 07V KQV, merret nga KQV-ja pas mbylljes së procesit të votimit, pasi kaloi ora 19.⁰⁰ dhe ka votuar edhe zgjedhësi i fundit në radhë, në kohën e mbledhjes së dokumentit të identifikimit.

Procesverbale që plotësohen kur rrezikohet rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit:

- Procesverbal i pezullimit të votimit (Model- 01 PV KQV), i cili plotësohet kur KQV ka njoftuar forcat e Policisë së Shtetit dhe KZAZ, në rastet kur në QV është rrezikuar rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit;
- Procesverbal i rifillimit të votimit (Model- 02 PV KQV), i cili plotësohet kur në QV është rivendosur rendi dhe KQV i kërkon forcave të Policisë së Shtetit të largohen nga QV .

Procesverbale të tjera

- Model PV-KQV-05: Procesverbal për pajisjen e KQV-së me materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja.

6. VEPRI ME TË KQV-SË PËRPARA HAPJES SË QENDRËS SË VOTIMIT

6.1 Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore nga KQV

KQV-ja, një ditë para ditës së zgjedhjeve, por jo më vonë se ora 15⁰⁰ e datës 6 maj 2017, merr në dorëzim materialet zgjedhore nga KZAZ-ja.

Materialet zgjedhore për çdo KQV merren në dorëzim nga Kryetari, Sekretari i KQV-së, si dhe çdo anëtar i KQV-së që kërkon të jetë i pranishëm. Materialet zgjedhore që KQV-ja merr në dorëzim nga KZAZ-ja, të cilat dokumentohen në procesverbalin Model PV-KQV-05, janë si më poshtë:

- ✓ Fletë votimi, në përputhje me numrin e zgjedhësve të regjistruar në atë qendër votimi me 2 % fletë votimi shtesë. Fletët e votimit merren të ambalazuara në blloqe prej 100 fletësh;
- ✓ Procesverbal, Model PV-KQV-07, i vulosjes së kutive të votimit përpara fillimit të votimit + Zarfi, model Z.01;
- ✓ Procesverbal i mbylljes së votimit (Model PV- KQV- 08)+ Zarfi, model Z.01;
- ✓ Një Kuti votimi ;
- ✓ Kuti e Materialeve Zgjedhore;
- ✓ Vula e KQV-së;
- ✓ Vula për kryetarin e KQV-së;
- ✓ Set i bojës timbruese (së posaçme);
- ✓ Set i zarfave për fletët e votimit të dëmtuara +të papërdoura, Z.02+Z.03;
- ✓ Dhoma të fshehtësisë;
- ✓ Dhoma të fshehtësisë për personat me aftësi të kufizuar;
- ✓ Set i modeleve të vendimeve dhe udhëzimeve të KQZ-së
- ✓ Dokumentacionin e punës së KQV-së:
 - Libri i protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, modelet e vendimeve;
 - Regjistri i Posaçëm i Zgjedhësve;
 - Manual dhe Fletore pune KQV;
 - Kod Zgjedhor, vendime, udhëzime, postera edukues, etj;
- ✓ Paketë me mjete kancelerie e materialeve zgjedhore;

Kujdes:


Numri i fletëve të votimit të marra në dorëzim të regjistrohet i saktë në Procesverbalin model PV-KQV-05

6.2 Marrja në dorëzim e vulave metalike me kodet e sigurisë

Vulat metalike me kodet e sigurisë dorëzohen me një procesverbal të veçantë PV-KZAZ-06, ku kodet e sigurisë regjistrohen për çdo vulë.

KQV merr në dorëzim vulat me kode sigurie si më poshtë:

- 5 (pesë) vula metalike me kode sigurie, me ngjyrë të zezë (me numër 6 shifror në ngjyrë të bardhë), që do të përdoren për mbylljen e kutisë së votimit,
- 4 (katër) vula metalike me kode sigurie, me ngjyrë të zezë (me numër 6 shifror në ngjyrë të bardhë) që do të përdoren për mbylljen e kutisë së materialeve zgjedhore;
- 3 (tri) vula rezervë, me ngjyrë të bardhë, për përdorim në rast dëmtimi të vulave me kode sigurie që u përdorën gjatë procesit të mbylljes së kutive.



Vula me kod sigurie,
me ngjyrë të zezë



Vula me kod sigurie rezervë,
me ngjyrë të bardhë

6.3 Marrja në dorëzim e vulës së kryetarit të KQV-së

Kryetari i KQV-së përkatëse në praninë e anëtarëve të KZAZ-së, kryen sipas radhës veprimet e mëposhtme:

- merr me zgjedhje rastësore një vulë nga grumbulli përkatës i vulave të paketuara;
- gris ambalazhin e vulës;
- vulos, në një letër të bardhë për të bërë modelin e krahasimit të vulës;
- shënon emrin dhe mbiemrin e tij, si dhe nënshkruan nën modelin krahasues të vulës;



Anëtarët e KZAZ-së nënshkruajnë në pjesën e pasme të letrës së bardhë me modelin krahasues (specimenin) të Vulës së Kryetarit të KQV-së dhe mbahet në ruajtje nga Sekretari i KZAZ-së në një dosje të veçantë së bashku me Modelin PV-KZAZ-06.

MODEL: PV-KZAZ-06

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROCESVERBAL

Qarku: TIRANË KZAZ: 01.02 Data: 05.05.2017
BASHKËA: KAVAJË KQV: 01.1117

No.	Numri i vulës së sigurisë	No.	Numri i vulës së sigurisë rezervë
1.	357241	1.	143228
2.	357241	2.	143228
3.	357241	3.	143228
4.	357241	4.	143228
5.	357241		
6.	357241		
7.	357241		
8.	357241		
9.	357241		

Shënimet nga KZAZ: _____ Shënimet në bashkësi nga KQV: _____

Kujdes: Ju mund t'i referoheni KZ, n.100/2 dhe 3

6.3 Lista e zgjedhësve

KQV-së i dorëzohet nga KZAZ-ja me procesverbal të veçantë Lista e Zgjedhësve. (Procesverbali përgatitet nga KZAZ-ja).

Kujdes: Lista e zgjedhësve do të përdoret nga KQV-ja ditën e Votimit.

Në procesverbalin e përgatitur nga KZAZ-ja për dorëzimin e saj shënohen:

- Lista e zgjedhësve të QV-së nr. _____ e KZAZ-së nr. _____, fillon me numrin rendor 1 (një) dhe mbaron me numrin rendor _____ me shifër dhe me fjalë),
- Numri i fletëve të listës së zgjedhësve është _____ (me shifër dhe me fjalë)

KUJDES! Të gjithë materialet e votimit, menjëherë pas marrjes në dorëzim, duhet të vendosen në Qendrën e Votimit.

Anëtarët e KQV-së, përpara se të largohen duhet të rregullojnë tryezat dhe karriget e KQV-së, të sistemojnë të gjitha materialet zgjedhore të tërhequra nga KZAZ-ja përkatëse mbrëmjen përpara zgjedhjeve.

Në kohën e largimit nga QV-ja, anëtarët e KQV-së:

- mbyllin dritaret e ambientit;
- mbyllin derën;
- kryejnë vulosjen e derës së QV-së me një symbol, të vendosur në plastelinë, të zgjedhur nga vetë ata, në prani të punonjësit të Policisë së Shtetit, i ngarkuar me shërbim për këtë QV.

Në asnjë rast, KQV-ja nuk duhet të nxjerrë materiale zgjedhore jashtë Qendrës së Votimit, dhe nuk duhet të largohet pa e siguruar Qendrën e Votimit.



Kujdes! Mos u largoni nga QV, nëse nuk është paraqitur punonjësi i Policisë së Shtetit dhe njoftoni KZAZ-në për mosparaqitjen e tij.


6.5 Ruajtja e materialeve zgjedhore një ditë para ditës së zgjedhjeve

Policia e Shtetit merr në ruajtje ambientin e QV-së që nga momenti kur anëtarët e KQV-së sjellin materialet zgjedhore në QV. Punonjësi i Policisë së Shtetit largohet nga KQV-ja, kur në qendrën e votimit paraqiten anëtarët e KQV-së për të kryer veprimet paraprake për fillimin e procesit të votimit.

II. ORGANIZIMI I QENDRËS SË VOTIMIT

1. Organizmi i qendrës së votimit

Hyrja në Qendrën e Votimit



Kujdes:

Largoni çdo pengesë nga hyrja e QV-së



Materialet që duhet të afishohen në ambientin e QV-së:

- poster i që shpjegon procesin e votimit;



Kujdes: Për organizimin e Qendrës së Votimit mbani parasysh:

- të krijoni hapësirë të mjaftueshme për lëvizjen e lire të votuesve në QV,
- për të siguruar fshehtësinë e votës, dhomat e fshehtësisë nuk duhet të vendosen pranë dritares.
- Vëzhguesit duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të mund të vëzhgojnë lirshëm procesin e votimit.

- postera që tregojnë se:

- ✓ veprimet e ndaluara në qendrën e votimit;
- ✓ votimi familjar dhe në emër të tjerëve është i paligjshëm.

Kujdes:


Nuk duhet të lejoni të ndodhë votim në grup/familjar. Anëtarët e KQV-së, të cilët kanë lejuar një votues të votojë më shumë sesa një herë në emër të votuesve të tjerë janë objekt i ndjekjes penale, në përputhje me nenin 248 të Kodit Penal.

- ndalohen armët, celularët, duhani.



Të rinjtë po shkelin ligjin.





III. VËZHguesIT

Vëzhguesit shqiptarë dhe të huaj që vëzhgojnë procesin e votimit në QV akreditohe nga KQZ-ja ose KZAZ-ja.

Në qendrën e votimit nuk mund të qendrojnë në të njëjtën kohë më shumë se:

- një vëzhgues i akredituar i:
 - Partive politike që nuk janë pjesë e koalicioneve;
 - Kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit;
 - Organizatave jo-fitimprurëse shqiptare;
- dy vëzhgues të akredituar të:
 - Një organizate jo-timprurëse të huaj,
 - Një organizatate ndërkombëtare.

Vëzhguesit e huaj mund të shoqërohen nga një përkthyes brenda ambienteve të QV-së. Përkthyesi është i pajisur me autorizimin përkatës lëshuar nga KQZ-ja.

- tre vëzhgues të akredituar të çdo koalicioni.

Kandidatët e partive politike nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues.

Kujdes!

- Vëzhguesi/vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, të akredituar në KZAZ, mund të vëzhgojnë procesin zgjedhor dhe në Qendrat e Votimit të kësaj Zone të Administrimit Zgjedhor.
- Komisioni i Qendrës së Votimit në asnjë rast, nuk mund të lejojë të jenë të pranishëm më shumë se tre vëzhgues të një koalicioni në një Qendër Votimi.

Sekretari i KQV-së u kontrollon vëzhguesve shqiptarë dhe të huaj

- dokumentin e akreditimit dhe
- dokumentin e identifikimit të vlefshëm [letër njoftimi/kartë identiteti ose pasaportë]

Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, vëzhguesit kanë këto të drejta:

- ✓ Të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;
- ✓ Të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;
- ✓ Të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor.

Vëzhguesit kanë këto detyra:

- ✓ Të respektojnë kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ-së;
- ✓ Të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat, parti politike apo koalicion në qendrat e votimit ku ato vëzhgojnë;
- ✓ Të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me akreditimin e vlefshëm;
- ✓ Të mos mbajnë shenja dalluese, që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit;
- ✓ Të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit dhe administrimit të zgjedhjeve.
- ✓ Të mos ndërhyjnë në procesin e votimit;
- ✓ Të mos bëjnë komente të vendimeve të KQV-së.

IV. PROCEDURAT PËR HAPJEN E VOTIMIT



Të gjithë anëtarët e KQV-së duhet të jenë të pranishëm në Qendrën e Votimit një orë përpara se të fillojë votimi.

Kontrollojnë nëse vula në derën e QV-së, ku ruhen materialet zgjedhore, është e paprekur; Nëse janë të pranishëm më pak se 4 anëtarë, KQV duhet të njoftojë menjëherë KZAZ-në

Kujdes! Kryetari, sekretari ose dy anëtarë të KQV-së njoftojnë menjëherë KZAZ-në për largim ose mungesa të anëtarëve të KQV-së gjatë ditës së votimit.
Vonesa për kryerjen e njoftimit mund të bëhet shkak për pavlefshmëri të zgjedhjeve.

Gjatë ushtrimit të detyrës, anëtarët e KQV-së janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.



1. Veprimet paraprake të KQV-së kryhen në prani të vëzhguesve

KQV:

- 1.1 Heq materialet propagandistike që mund të ndodhen në QV ose rreth saj në një rreze prej 150 m;
- 1.2 Vendos materialet e kërkuara nga KQZ-ja (postera);
- 1.3 Hap dhe inventarizon materialet zgjedhore, duke u bazuar në procesverbalet përkatëse për:
 - pajisjen e KQV-së me materiale zgjedhore nga KZAZ-ja, model PV-KQV-05;
 - pajisjen e KQV-së me vula me kode sigurie, model PV-KZAZ-06;
 - dorëzimin nga KZAZ-ja të listës së zgjedhësve të QV-së;
- 1.4 Merr vendim për caktimin e detyrave të anëtarëve të KQV-së, MODEL-01V KQV, për detyrat e poshtëshënuara:
 - ✓ Ruajtjen e radhës së votimit të zgjedhësve në hyrje të QV-së;
 - ✓ Kontrollin e duarve të zgjedhësit, nëse është ose jo i timbruar me bojën e posaçme;
 - ✓ Timbrimin me bojë të posaçme [të gishtit të madh të dorës së majtë] të zgjedhësit, pasi është pajisur me fletën e votimit;
 - ✓ Garantimin e hyrjes në dhomën e fshehtësisë vetëm të një zgjedhësi, me përjashtim të rastit, kur zgjedhësi, për arsye fizike, nuk mund të votojë vetë.
 - ✓ Orientimin e zgjedhësit për të hedhur fletën e votimit në kutinë e votimit.
- 1.5 Vulos (Mbyll) kutinë e votimit sipas procedurës:
 - a. U tregon vëzhguesve kutinë e votimit të zbrazët;
 - b. Shënon, paraprakisht, në:
 - Procesverbalin e Vulosjes së kutisë së votimit, MODEL PV-KQV-07,
 - Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, numrat [gjashtëshifrorë] të kodeve të çdo vule sigurie, me ngjyrë të zezë;
 - c. Vulos (mbyll) kutinë e votimit me kodet e sigurisë, në mënyrë të tillë që të mos lejojë hapësira mes kutisë dhe kapakut të saj.

Kujdes! Kutia e votimit mbyllet me katër vula me kode sigurie.
Hapësira e kapakut të kutisë së votimit, ku futet fleta e votimit, vuloset pas procesit të mbylljes së votimit

Në rast se ndonjë nga vulatat me kodet e sigurisë dëmtohet gjatë mbylljes së kutisë së votimit, ajo zëvendësohet me një nga vulatat rezervë.

Në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe në Procesverbalin e Vulosjes, MODEL PV-KQV-07, Sekretari shënon:

Numrin [gjashtëshifror] të kodit të sigurisë të vulës së dëmtuar, me ngjyrë të zezë; dhe numrin e kodit të sigurisë së vulës rezervë, me ngjyrë të bardhë.

ç. Nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së:

- ✓ Procesverbali i Vulosjes së kutisë së votimit, MODEL PV - KQV - 07 dhe
- ✓ Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

d. Vuloset nga Sekretari i KQV-së, Procesverbali i Vulosjes së kutisë së votimit, MODEL PV-KQV-07 (edhe kopjet e tij).

dh. Mbyllet nga Sekretari i KQV-së , Procesverbali Model PV- KQV-07 në dy zarfa të etiketuar “ZARFI I PROCESVERBALIT TË VULOSJES”, model Z.01 dhe futet në :

- Kutinë e Votimit, njëri zarf me procesverbalin [origjinal] MODEL PV-KQV-07, fig.1;
- Kutinë e Materialeve Zgjedhore, zarfi tjetër me procesverbalin [kopje] MODEL PV-KQV-07, fig.2, para fillimit të procesit të votimit.

fig.1

fig.2

Kopje të këtij procesverbali u jepen anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të akredituar, nëse e kërkojnë. Sekretari i KQV-së shënon numrin e kodeve të vulave të sigurisë edhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

e. Anëtarët e KQV-së, marrin vendim për hapjen e votimit, MODEL-02V KQV dhe e nënshkruajnë atë.

V. VOTIMI

Orari i Votimit



1. Personat e autorizuar për të qënë të pranishëm në qendrën e votimit

Në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm:

- a) anëtarët e KQV-së;
- b) zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit;
- c) vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe të huaj.

Kujdes: Kandidatët nuk lejohen të jenë të pranishëm në QV, përveç rastit kur janë duke votuar!

Asnjë person i armatosur nuk lejohet të qëndrojë në mjediset e qendrës së votimit.

Përfshihen nga ky rregull punonjësit e Policisë së Shtetit, kur janë duke ushtruar detyrën në përputhje me nenin 109 të KZ.

1. Prania e anëtarëve të KQV-së gjatë votimit

Sekretari i KQV-së shënon në LPM të KQV-së kohën e largimit dhe të kthimit të çdo anëtari të KQV-së nga qendra e votimit. Kur kryetari largohet nga qendra e votimit, ai i kalon një anëtari tjetër me të njëjtën përkatësi politike deri në çastin e rikthimit të tij, vulën e kryetarit, listën zgjedhësve, Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve, zarfin me fletët e dëmtuara.



Sekretari i KQV-së bën shënimin përkatës në LPM të KQV-së, kur edhe ai/a jo vetë largohet nga qendra e votimit.

Në këtë rast vula e KQV-së, LPM dhe fletët e votimit i kalojnë për përdorim një anëtari me të njëjtën përkatësi politike deri në rikthimin e sekretarit të KQV-së. Në LPM të KQV-së bëhet shënim përkatës për pasqyrimin e faktit, kur ai/a jo kthehet në detyrë.

2. Përdorimi i vulave

Zgjedhësi voton me një fletë votimi.

Përpara se t'i jepet zgjedhësit, fleta e votimit, në pjesën e pasme të saj, vulozet me vulën e KQV-së dhe me vulën e kryetarit të KQV-së.



Vula e KQV-së përmban tekstin "KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT" dhe numrin e qendrës përkatëse të votimit.

Vula e kryetarit të KQV-së përmban tekstin "KRYETARI" dhe një numër serial pesëshifror. Vula e kryetarit të KQV-së përdoret vetëm për vulosjen e fletëve të votimit dhe për asnjë dokument tjetër zgjedhor.

3. Pajisja e KQV-së, menjëherë, me vulë rezervë, në rast se:

- një nga vulat është dëmtuar ose ka humbur;
- një nga vulat është nxjerrë jashtë qendrës së votimit.

Vula e dëmtuar, e humbur ose e nxjerrë jashtë qendrës së votimit nxirret jashtë përdorimit me vendim të KQZ-së.



Fakti i nxjerrjes së vulës nga përdorimi shënohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, si dhe ora e ndodhjes së këtij fakti.

Kujdes:

Njoftoni menjëherë KZAZ-në për rastet e dëmtimit, humbjes së vulës ose nxjerrjes së saj jashtë Qendrës së Votimit;

Përdorimi i vulës rezervë shmang rastet e pezullimit, bllokimit apo pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendrën e votimit;

Dorëzimi i vulës rezervë në KQV do të bëhet me procesverbal të veçantë, Model PV-2/Vulë Rezervë, të cilin e nënshkruajnë, krahas emrit, mbiemrit kryetari dhe sekretari i KQV-së.

Sekretari i KQV-së mban procesverbal dhe regjistron në LPM të gjitha veprimet e mësipërme, si dhe orën për çdo veprim të kryer nga KQV-ja.

Dëmtimi i qëllimshëm ose nxjerrja e vulës jashtë qendrës së votimit përbën vepër penale dhe ndëshkohet sipas nenit 326/a të Kodit Penal.

V. PROCEDURAT GJATË VOTIMIT

Kujdes!

- Përdorimi i telefonave celularë dhe çdo lloj kamere dhe videokamere ndalohet të përdoret brenda ambienteve të QV-së, me përjashtim të:
- Medias së akredituar, e cila mund të lejohet të bëjë filmim të shkurtër të procesit zgjedhor, por pa kompromentuar fshehtësinë e votimit.

Kujdes!

Fikni celularët gjatë kohës që jeni në qendrën e votimit.
Fotografimi i fletës së votimit të shënuar është rreptësisht i ndaluar.

Anëtarë të KQV-së!

Mos lejoni asnjë zgjedhës në dhomën e fshehtësisë me celular në dorë apo çantë.

Vetëm sekretari i KQV-së, komunikon me sekretarin e KZAZ-së për hapjen dhe mbylljen e procesit të votimit, si dhe për pjesëmarrjen në votim.

1. Paraqitja e zgjedhësit në QV dhe votimi

Zgjedhësi

- hyn në qendrën e votimit
- thotë emrin e tij/saj
- paraqet para KQV-së një nga dokumentet e vlefshme të identitetit: letër njoftimi [kartë identiteti] ose pasaportë biometrike.
- Kryetari kontrollon emrin në listën e zgjedhësve;




Ndërkohë

- Një anëtar kontrollon zgjedhësit në të dy duart, në çastin e paraqitjes para KQV-së dhe para marrjes së fletës së votimit, nëse është timbruar ose jo me lëndën e posaçme.



KUJDES: Në rast se zgjedhësi është timbruar, anëtari përgjegjës i KQV-së, për kontrollin e duarve të zgjedhësve, ia bën të ditur menjëherë këtë fakt anëtarëve të tjerë të KQV-së, të cilët e verifikojnë menjëherë. Emri dhe mbiemri i këtij zgjedhësi shënohen në LPM të KQV-së dhe atij nuk i jepet fletë votimi.

- Kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e dokumentit të identitetit si dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë;
- Zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij, përbri numrit të dokumentit të identifikimit;
- Para se zgjedhësit t'i jepet fleta e votimit, ajo vulozet në pjesën e pasme të saj nga:
 - ✓ Sekretari me vulën e KQV-së;
 - dhe
 - ✓ Kryetari me vulën e kryetarit të KQV-së.
- Një anëtar tjetër, i caktuar me vendim të KQV-së, timbros zgjedhësin në gishtin e madh të dorës së majtë me bojë të posaçme [tip "Marker"].
- Sekretari i jep zgjedhësit fletën e votimit.



KUJDES!

Në rast se zgjedhësi nuk pranon të timbroset me bojën e posaçme, atij nuk i jepet fleta e votimit dhe identiteti i tij mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

Në rast se një votues nuk e ka gishtin e majtë të dorës së majtë, ai timbroset në gishtin e madh të dorës së djathtë.

Pasi merr fletën e votimit,

- zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtësisë dhe shënon në krah të emrit të subjektit zgjedhor [kandidatit për kryetar bashkie]
- shenjen "X", , " + ", O ose/apo një shenjë tjetër që shpreh vullnetin e zgjedhësit.



- Zgjedhësi, pasi bën shënimin në fletën e votimit, palos fletën e votimit brenda dhomës së fshehtësisë në mënyrë që:
 - ✓ shenja të mos jetë e dukshme, por të paktën
 - ✓ një nga vulat në pjesën e pasme të fletës së votimit të jetë e dukshme.



- Zgjedhësi, pasi del nga dhoma e fshehtësisë, orientohet të hedhë fletën e votimit në kutinë e votimit

dhe

- largohet nga qendra e votimit.



2. Regjistri i Posaçëm i Zgjedhësve, zgjedhësit e veçantë [n.58 KZ]

Kur në KQV paraqitet një zgjedhës, i cili nuk është regjistruar në listën e zgjedhësve, por është i pajisur me vendim gjykate për të votuar në këtë qendër votimi, atëherë ai ka të drejtë të votojë.

KQV-ja shënon në Regjistrin e Posaçëm: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen e zgjedhësit, numrin e vendimit të gjykatës të paraqitur, numrin e dokumentit të identifikimit.

Zgjedhësi që voton me vendim gjykate nënshkruan në regjistrin e posaçëm anash emrit të tij, përbri numrit të dokumentit të identifikimit.



Regjistri i Posaçëm i Zgjedhësve



Vendimi i Gjykatës

Kujdes: Vendimi i Gjykatës, i çdo zgjedhësi që paraqitet i pajisur me të për të votuar, i bashkangjitet Regjistrit të Posaçëm të Zgjedhësve.

Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së votojnë në qendrën e votimit më të afërt të caktuar me vendim të KZAZ-së, pavarësisht nëse e kanë ose jo emrin në listën e zgjedhësve të asaj qendre votimi. Anëtarët e KZAZ-së pajisen nga sekretari i saj me vërtetim të posaçëm që dëshmon numrin e qendrës së votimit, që KZAZ-ja ka përcaktuar me vendim. Anëtarët e KQV-së votojnë përpara mbylljes së votimit, pasi kanë përfunduar procedurat e votimit zgjedhësit e pranishëm, në radhë, të cilëve iu është marrë dokumenti i identifikimit në orarin e caktuar për mbylljen e votimit.

Anëtarët e KQV-së votojnë në qendrën e votimit ku ata janë emëruar/caktuar anëtarë komisioni, pavarësisht nëse e kanë ose jo emrin në listën e zgjedhësve në atë qendër votimi.

Në Librin e Protokollit të Mbledhjes regjistrohet fakti i votimit të anëtarëve të KQV-së, Anëtar i KQV-së, i cili nuk e ka emrin në listën e zgjedhësve të kësaj QV-je,

- Bën deklaratë në LPM, ku
- Deklaron, që nuk ka votuar në qendrën e votimit, ku është i regjistruar sipas vendbanimit, dhe
- Nënshkruan këtë deklaratë, para se ai të votojë.

Kujdes! TË DHËNAT IDENTIFIKUESE NË REGJISTËR, NË TË GJITHA RASTET DUHET TË PLOTËSOHEN SAKTËSISHT DHE ME SHKRONJA TË MËDHA. Në rastet kur votojnë anëtarët e KQV-së apo KZAZ-së në kolonën ku shkruhet "Numri dhe data e vendimit të gjykatës", shënohet "Anëtar i KQV-së/Anëtar i KZAZ-së". Vendimi dhe Vërtetimi i KZAZ-së i bashkangjitet këtij Regjistri.

Sekretari i KQV-së regjistron në LPM vendimin e KZAZ "Për caktimin e QV për votimin e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së", MODEL-10V KZAZ.

Në mbyllje të procesit të votimit, (pasi kanë votuar edhe anëtarët e KQV-së) kryetari i KQV-së bën shënimin:

Ky regjistër mbyllet me numër rendor _____ (me shifër) _____ (me fjalë) dhe e firmos atë.

3. Votuesit që nuk mund të votojnë vetë

Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e

një zgjedhësi [familjar ose jo], por që e ka emrin në listën e zgjedhësve të kësaj QV-je.



Kujdes!

Para se të shënojë në fletën e votimit, personi që ndihmon një zgjedhës tjetër, bën një deklaratë në LPM të KQV-së, të cilën e nënshkruan përbri emrit dhe mbiemrit të tij. Në këtë deklaratë ai shënon edhe numrin e dokumentit të letërnjoftimit ose pasaportës.

DEKLARATË

e personit që ndihmon një zgjedhës sipas nenit 108 të Kodit Zgjedhor
(modeli i pasqyruar në Librin e Protokollit të Mbledhjeve)

Unë z/zj _____, në prani të z/znj _____, i/e cili/a kërkoi të ndihmohet, për shkak se nuk mund të kryejë vetë procedurat e votimit, marr përsipër të ndihmoj zgjedhësin/en me miratimin e plotë të tij/saj, dhe deklaroj me përgjegjësi të plotë: 1. Se do të votoj sipas udhëzimeve të zgjedhësit që po ndihmoj;
2. Se nuk do të ndikoj në vendimin e tij/saj;
3. Se nuk do të bëj publike votën e tij/saj;
4. Se nuk kam votuar dhe nuk do të votoj për llogari të një zgjedhësi tjetër.

Të ngjashme me këtë model, shënohen në faqet vijuese të Librit të Protokollit të Mbledhjeve të gjitha deklaratat e tjera për raste të ngjashme.

Kujdes!

Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në QV, kur nënshkruhet kjo deklaratë. Një zgjedhës mund të ndihmojë vetëm një votues, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit.

Anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve dhe sekretari nuk mund të ndihmojnë asnjë zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.

Shënimi në fletën e votimit bëhet detyrimisht në dhomën e fshehtësisë.

4. Fletë votimi e dëmtuar

Fleta e votimit do të shënohet në pjesën e pasme "E DËMTUAR", në tre rastet kur:

- Zgjedhësi bën shënimin në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtësisë. Në këtë rast zgjedhësi nuk lejohet të fusë fletën e votimit në kuti. Kryetari i KQV-së merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët "E DËMTUAR" dhe e fut atë në zarfin e etiketuar "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA" Z.03.
- Zgjedhësi bën shënim ose e dëmton fletën e votimit pa dashje dhe kërkon një fletë votimi të dytë. Fleta e votimit konsiderohet e dëmtuar dhe futet në zarfin "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA".
- Zgjedhësi fotografon në dhomën e fshehtësisë fletën e votimit. Kryetari i KQV-së merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët "E DËMTUAR" dhe e fut në zarfin "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA".

Kujdes! Në këto tre raste, zgjedhësit i jepet fletë votimi tjetër dhe çdo rast mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

Nëse zgjedhësi:

- shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtësisë, ose
- dëmton përsëri pa dashje fletën e dytë të votimit, apo
- fotografon sërish fletën e votimit në dhomën e fshehtësisë, edhe fletët e dyta të votimit futen në zarfin "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi.

Kujdes!

Në qendrën e votimit nuk lejohet përdorimi i telefonisë celulare nga ana e zgjedhësit dhe zgjedhësi nuk duhet të lejohet të votojë duke mbajtur aparatit telefonik në dorë.

Kryetari i KQV-së, në të gjitha rastet e dëmtimit apo fotografimit të fletës së votimit shënon në pjesën e pasme të fletës së votimit fjalën "E DËMTUAR".

Sekretari i KQV-së në të gjitha rastet shënon në LPM emër mbiemër të zgjedhësit që ka dëmtuar/fotografuar fletën e votimit.

NË ASNJË RAST FLETËT E VOTIMIT TË DËMTUARA NUK HIDHEN NË KUTINË E VOTIMIT

5. Dërgimi i informacionit për pjesëmarrjen në votim

Sekretarët e QV-ve do të dërgojnë tek sekretari i KZAZ-së të dhënat në oraret, si më poshtë:

- 07:00 Informacion për orën e hapjes së qendrës së votimit;
- 10:00 Informacion për numrin e pjesëmarrjes në votim (nr. i zgjedhësve, që kanë votuar);
- 13:00 Informacion për numrin e pjesëmarrjes në votim;
- 16:00 Informacion për numrin e pjesëmarrjes në votim;
- 19:00 Informacion për orën e mbylljes së qendrës së votimit (sipas rastit),
- Në mbylljen e e votimit:
 - ✓ numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar në atë QV;
 - ✓ numrin e përgjithshëm të femrave që kanë votuar.

Kujdes: Transmetimi i informacionit për pjesëmarrjen në votim bëhet me mesazh zanor me anë të telefonit celular.

Mosdërgimi i informacionit ngarkon me përgjegjësi Sekretarin e QV-së. Partitë politike, bashkë me propozimin për emrat e anëtarëve të KQV-ve, që do të jenë Sekretarë të KQV-ve depozitojnë edhe numrin e celularit të tyre.

Ju mund t'i referoheni Vendimit nr.13/2015:

"Për miratimin e procedurave për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e informacionit ditën e votimit".

VI. MBYLLJA E VOTIMIT

Qendrat e Votimit mbyllesh në orën ora 19.⁰⁰



1. Votuesit në radhë

Kryetari i KQV-së, në konsultim me anëtarët e tjerë, konstaton se ora është 19⁰⁰, pyet anëtarin që mban rregullin [me detyrë për ruajtjen e radhës], nëse ka zgjedhës për të votuar.

Nëse ka zgjedhës në radhë, që presin për të votuar, Kryetari së bashku me Sekretarin

- cakton dy anëtarë të KQV-së, pozitë opozitë, për të mbledhur dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve që janë të pranishëm në radhë, në orën 19⁰⁰.
- thërrasin zgjedhësit, të cilëve iu mbledhën dokumentet e identifikimit, për të kryer votimin një nga një.

Asnjë zgjedhës tjetër nuk lejohet të votojë, nëse nuk ka qenë në radhë në kohën, kur janë mbledhur dokumentet e identifikimit.

2. Vendimi për mbylljen e votimit

Pasi voton zgjedhësi i fundit i pranishëm (edhe anëtarët e KQV-së), Kryetari:

- drejton mbledhjen për mbylljen e votimit dhe
- urdhëron Sekretarin e KQV-së të plotësojë vendimin "Për mbylljen e votimit", MODEL-07V KQV.

Vendimi "Për mbylljen e votimit" [MODEL- 07V KQV] dhe ora e saktë e mbylljes së tij shënohen edhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

Kujdes! Pas kësaj, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët dhe sekretari i KQV-së, si dhe vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe/ose të huaj dhe përfaqësuesit e akredituar të medias.

3. Veprimet pas mbylljes së votimit

Pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit,

Kryetari nën vëzhgimin e anëtarëve, kryen, sipas radhës, veprimet e mëposhtme:

- Numëron, shënon dhe llogarit zgjedhësit që kanë votuar, bazuar në nënshkrimet e bëra në:
 - Listën e zgjedhësve, dhe
 - Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve;
- I deklaron me zë të lartë anëtarëve të tjerë të KQV-së dhe vëzhguesve të pranishëm shifrën e zgjedhësve që kanë votuar;
- I fton ata të verifikojnë shifrën e thënë prej tij;
- Urdhëron Sekretarin e KQV-së të shënojë në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit, PV-KQV-08 dhe në LPM të KQV-së:
 - ✓ numrin e zgjedhësve, që kanë votuar në QV;
 - ✓ numrin e femrave që kanë votuar [kjo shifër duhet të shënohet në PV-KQV-08, nën shifrën e numrit të zgjedhësve, që kanë votuar];
 - ✓ numrin e plotë të fletëve të votimit të qendrës së votimit, duke u bazuar tek të dhënat që kanë shoqëruar marrjen në dorëzim të fletëve të votimit, sipas Procesverbalit Model PV-KQV-05.

Kujdes! Nëse një anëtar ka kundërshtime mbi shifrën e deklaruar për përcaktimin e numrit të zgjedhësve që kanë votuar,

Kryetari urdhëron Sekretarin e KQV-së të shënojë pretendimet në:

- Librin e Protokollit të Mbledhjeve;
- Procesverbalin për Mbylljen e Votimit, PV-KQV-08; dhe
- Faqen e dytë të vendimit "Për përcaktimin e numrit të personave që kanë votuar", MODEL-08V KQV.

- Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së:
 - Numëron fletët e votimit të papërdorura dhe
 - Ia bën të ditur shifrën anëtarëve të KQV-së.
 - Rinumëron, sërish, fletët e votimit të papërdorura, nëse kërkohet nga ndonjë anëtar apo vëzhgues; dhe



Sekretari:

- Shënon në:
 - ✓ Procesverbalin për Mbylljen e Votimit, PV-KQV-08 dhe LPM,
 - ✓ nëse ka vërejtje nga anëtarët
 - ✓ LPM, nëse ka vërejtje nga vëzhguesit;

Kryetari:

- Mbyll fletët e votimit të papërdorura në zarfin e etiketuar "FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA", Z.02, në përfundim të numërimit.

Ë Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së,

- Numëron fletët e votimit të dëmtuara, që gjenden në zarfin e etiketuar "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA", Z. 03.
- Ia deklaron anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve; Numri i fletëve të votimit të dëmtuara pasqyrohet në:
 - Procesverbalin për Mbylljen e Votimit PV-KQV-08,
 - dhe LPM të KQV-së.



Sekretari

- Shënon në:
 - ✓ PV-KQV-08 dhe LPM , nëse ka vërejtje nga anëtarët e KQV-së;
 - ✓ LPM , nëse ka vërejtje nga vëzhguesit.

Kryetari:

- Mbyll fletët e votimit të dëmtuara në zarfin e etiketuar "ZARFI FLETËVE TË VOTIMIT TË DËMTUARA", Z.03.

Kujdes! Vërejtjet me shkrim nga vëzhguesit, Sekretari i administron dhe i mbyll në Kutinë e Materialeve të Votimit, së bashku me dokumentacionin tjetër të qendrës së votimit.

Kujdes! Vendosni në zarfin "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA", Z. 03: fletë votimi të dëmtuara.

Referohuni etiketës "KUJTESË" në kapakun e kutisë së materialeve të votimit!

- Ë Në përfundim të veprimeve të parashikuara më lart, Sekretari i KQV-së mbyll në kutinë e materialeve të votimit, materialet e mëposhtme:
 - ✓ zarfin "FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA" (në zarf, Z. 02);
 - ✓ zarfin "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA" (në zarf , Z.03);
 - ✓ listën e zgjedhësve, regjistrin e posaçëm të zgjedhësve, përfshirë edhe vendimet e gjykatës, vendimin e KZAZ-së për caktimin e QV-së për votimin e anëtarëve të KZAZ-së (vërtetimet e KZAZ-së), nëse ka;
 - ✓ origjinalet e vendimeve të KQV-së dhe formularët tip të papërdorur të vendimeve të KQV-së;
 - ✓ vulat me kodet e sigurisë të papërdorura;
 - ✓ vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara;
 - ✓ vulën e kryetarit të KQV-së; dhe
 - ✓ vulën e KQV-së;
 - ✓ Librin i Protokollit të Mbledhjeve.

Kujdes! Mos i vulosni ende, kutinë e votimit dhe kutinë e materialeve të votimit!

Kryetari:

- Urdhëron Sekretarin e KQV-së të shënojë, paraprakisht, në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit [PV-KQV-08] dhe Librin e Protokollit të Mbledhjeve [LPM].
- numrin [gjashtëshifror] të kodit të vulës së fundit [së pestë] të sigurisë me të cilën do të mbyllet hapësira, ku hidhet fleta e votimit, në kutinë e votimit;
- numrat [gjashtëshifrorë] të kodeve të vulave të sigurisë, me të cilat do të mbyllet kutia e materialeve të votimit;

Pasi hidhen të gjitha të dhënat në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit, PV-KQV-08,

- Shënohet në procesverbalin PV-KQV-08 edhe ora e saktë të mbylljes së tij;
- Nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së:
 - ✓ Procesverbalin për Mbylljen e Votimit, PV-KQV-08 dhe
 - ✓ Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.
- Vuloset me vulën e KQV-së, Procesverbali për Mbylljen e Votimit, PV-KQV-08 [edhe kopjet tij];
- Mbyllet, nga Sekretari i KQV-së, Procesverbali i Mbylljes së Votimit PV-KQV-08 [origjinali dhe njëra nga kopjet] në dy zarfa të etiketuar "ZARFI I PROCESVERBALIT TË VULOSJES SË KUTISË TË VOTIMIT", dhe
- Futet në:
 - ✓ Kutinë e votimit me fletët e votimit, njëri zarf me procesverbalin [origjinal] Model PV-KQV-08, në fillim, fig.1;
 - Kryetari, menjëherë, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së, mbyll me vulën e fundit [e pestë], me kod sigurie, hapësirën nga e cila hidhet fleta e votimit, kutinë e votimit me fletët e votimit.

REPUBLICA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE

PROCESVERBAL

Luftëtarët, shqiptarë, për zgjedhjet e përgjithshme për Kryetar të Bashkisë Kavajë, Qarku Tiranë, më datën 07 maj 2017

Shënimet: më 15 nga 10 maj 2017, si dhe nga 10 maj 2017 dhe nga 15 maj 2017.

Qarku: TIRANË
Qendri: 08.05.2017

KQV Nr: 2168

KQV Nr: 2168

KOMISIONI Qendror i Zgjedhjeve dhe të fuqet e kushtetut, votimit për Kryetarin e Bashkisë, më datën 07 maj 2017

Të dhëna për zgjedhjet dhe fletët e votimit	Për shifër	Për fletë
Nr. i postit i fletëve të votimit të QV-së/ për kushtetut për Kryetar Bashkie	150	150
Nr. zgjedhësve që kanë votuar sipas ndarjeve të votimit të QV-së, si dhe sipas të cilëve është regjistruar e përcjellur	600	600
Nr. fletëve të votimit të cilat janë të papërcjellura për kushtetut për Kryetar Bashkie	250	250
Nr. fletëve të votimit të cilat janë të papërcjellura për Kushtetut për Kryetar Bashkie	150	150
Nr. fletëve të votimit të cilat janë të papërcjellura për Kushtetut për Kryetar Bashkie	10	10

1. Kodi i vullës së postit për shifërjen e kutisë së votimit për Kryetar bashkie: no. 354251

2. Në rast se vullëti me kodet e rezervës dëmtohet gjatë mbylljes, ajo zëvendësohet me vullëtin rezervë me kodet:

1. 354252 2. 354253 3. 354254 4. 354255

Komisioni i Qendrës së Votimit: Kryetari: [Signature]

Sekretar: [Signature]

VULLA e SHQIPËRISË

PROCESVERBALI i mbylljes së votimit 08.05.2017

fig. 1

Kujdes: Në rast se vula me kode sigurie, me ngjyrë të zezë, dëmtohet gjatë mbylljes së kutisë, ajo zëvendësohet me një nga vulat rezervë, me ngjyrë të bardhë.

Në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit, PV-KQV-08, dhe Librin e Protokollit të Mbledhjeve [LPM] shënohet numri [gjashtëshifror] i kodit të sigurisë të vulës së dëmtuar, me ngjyrë të zezë; dhe numri i kodit të sigurisë të vulës rezervë, me ngjyrë të bardhë.

- ✓ Kutinë e Materialeve të Votimit, Zarfi tjetër me Procesverbalin për Mbylljen e Votimit [kopja e tij], Model PV-KQV-08, fig.2.

No. i artikullit	Përshkrimi	No. i fletës
1	1 kuti e fletëve të votimit të (KQV) për bashkitë për Kryetar Bashkie	200
2	1 kuti e materialeve të votimit të (KQV) për bashkitë për Kryetar Bashkie	600
3	1 kuti e fletëve të votimit të (KQV) të bashkuara për bashkitë për Kryetar Bashkie	250
4	1 kuti e materialeve të votimit të (KQV) të bashkuara për bashkitë për Kryetar Bashkie	250
5	1 kuti e materialeve të votimit të (KQV) të bashkuara për bashkitë për Kryetar Bashkie	10

Kujdes!
 Kutia e materialeve të votimit mbyllet, menjëherë, me katër vulat, përkatëse, me kode sigurie, me ngjyrë të zezë, pasi në të janë futur të gjitha materialet e votimit.

Sigurohuni që vulat me kodet e sigurisë në kutinë e votimit me fletët e votimit dhe kutinë e materialeve të votimit i keni vendosur në mënyrë të tillë që nuk lejojnë hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut, në të kundërt përbëjnë shkak që kutia/kutitë të vlerësohet/ të vlerësohen: "KUTI E PARREGULLT"

fig.2

Kopje të Procesverbalit PV-KQV-08 u jepen anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve, nëse e kërkojnë.

4. Dërgimi dhe dorëzimi i Kutisë së Votimit me Fletët e Votimit dhe Kutisë së Materialeve të Votimit në VNV

- Kutia e Votimit me Fletët e Votimit dhe
 - Kutia e Materialeve të Votimit
- dorëzohen në Vendin e Numërimit të Votave të KZAZ-së përkatëse, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se ora 22⁰⁰ [jo më vonë se 3 orë nga mbyllja e votimit].

Me kryerjen e të gjithë procedurave për mbylljen e votimit, Kryetari, Sekretari i KQV-së dhe punonjësi i policisë i caktuar për shoqërimin e Kutisë së votimit me fletët e votimit dhe Kutisë së Materialeve të Votimit dërgojnë materialet në VNV-në përkatëse.

Dërgimi i tyre bëhet me automjet, në të cilin ndodhen:

- Kryetari, sekretari dhe anëtarët e KQV-së në qoftë se dëshirojnë;
- Punonjësi i Policisë së Shtetit, i cili ka për detyrë të garantojë integritetin e materialeve zgjedhore, në asnjë rast nuk ka të drejtë të ketë kontakt [mbajë ose ngrejë] materialet e votimit. Punonjësi i policisë duhet në çdo moment të mbajë uniformën e Policisë së Shtetit dhe të ketë në një vend të dukshëm dokumentin identifikues.

Kujdes!

Gjatë transportit kujdesuni që kutitë të mos dëmtohen (në trupin ose kapakun e tyre). Dëmtimet (thyerje apo çarje) që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit ose materialit tjetër të votimit përbëjnë shkak që kutia/kutitë të vlerësohet/ të vlerësohen "KUTI E PARREGULLT".

Dorëzimi i Kutisë së votimit me fletët e votimit dhe Kutisë së Materialeve të Votimit në VNV-në përkatëse dokumentohet me procesverbalin Model PV–KZAZ–09.

Kopje të procesverbalit të dorëzimit Model PV–KZAZ–09 marrin:

- Sekretari i KQV-së;
- Punonjësi i policisë që ka shoqëruar Kutinë e Votimit me fletët e votimit dhe Kutinë e Materialeve të Votimit.
- KZAZ, e cila mban edhe origjinalin e procesverbalit Model PV–KZAZ–09, të cilën e dorëzon në KQZ.

VIII - PËRGJEGJËSITË DHE SANKSIONET

Rastet e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor, i ngarkojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore me përgjegjësi penale dhe administrative, sipas legjislacionit:



RASTET E PËRGJEGJËSISË PENALE DHE ADMINISTRATIVE
TË ANËTARËVE DHE SEKRETARIT TË KQV-SË

a	Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve, kur nuk përbën veprë penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë (Kodi Zgjedhor, neni 171/1);
b	Shkelja e rregullave të përcaktuara në nenit 41 të Kodit Zgjedhor, përkatësisht nga sekretari i KQV-së, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë ose me burgim deri në 6 muaj (Kodi Zgjedhor, neni 171/3);
c	Shkelja e ndonjërit nga parimet e përgjithshme të përcaktuara në nenin 3 të Kodit Zgjedhor, në rastet kur kjo shkelje nuk ka ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë(Kodi Zgjedhor, neni 172/1);
ç	Kur shkelin rregullat e tjera të parashikuara në Pjesën II të KZ dhe kur nuk përbën shpërdorim të detyrës sipas nenit 248 të Kodit Penal, dënohen me gjobë nga 10 000 deri në 100 000 lekë (Kodi Zgjedhor, neni 171/5);
d	Gjobat vihen nga KQZ-ja, përbëjnë titull ekzekutiv dhe ekzekutohen sipas procedurave të parashikuara në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjobat, sipas pikës 1 të nenit 172 të Kodit Zgjedhor, vihen nga KQZ-ja.
Ju mund t'i referoheni Kodit Zgjedhor, neni 171, neni 172.

Veprat Penale

<p>Shpërdorimi i detyrës (Kodi Penal, neni 248, i ndryshuar)</p> <p>Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve apo e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.</p> <p>Anëtarët e KQV-së, që lejojnë një zgjedhës të votojë më shumë se një herë ose në emër të zgjedhësve të tjerë mbajnë përgjegjësi penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, me përjashtim të nenit 108 të Kodit Zgjedhor.</p>
<p>Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve (Kodi Penal, neni 326)</p> <p>Falsifikimi, shpërndarja ose përdorimi i fletëve të votimit, i dokumenteve dhe materialit zgjedhor, me qëllim ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve nëpërmjet paraqitjes në to të të dhënave, që dihen se janë të pasakta, zëvendësimi i të saktave me të rreme ose nëpërmjet futjes në kuti të fletëve të votimit në mënyrë të paligjshme dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.</p> <p>Po kjo veprë kur kryhet nga personat që kanë për detyrë të administrojnë procesin zgjedhor, ose ka sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e votimit, ka cenuar integritetin e rezultatit të zgjedhjeve apo ka sjellë pavlefshmërinë e tyre, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.</p>
<p>Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor (Kodi Penal, neni 326/a)</p> <p>Dëmtimi, prishja, shkatërrimi me dashje, apo zëvendësimi në kundërshtim me ligjin i pajisjeve, vulave, kodeve të sigurisë apo çdo materiali tjetër zgjedhor të parashikuar nga ligji, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.</p> <p>Po këto vepra kur kryhen nga personat përgjegjës për administrimin zgjedhor ose në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, apo kur kanë sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e zgjedhjeve, kanë sjellë pavlefshmërinë e tyre apo kanë cenuar rezultatin e votimit, dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet.</p>
<p>Shkelja e fshehtësisë së votës (Kodi Penal, neni 327)</p> <p>Shkelja e rregullave, që garantojnë fshehtësinë e votimit nga ana e personave përgjegjës për zgjedhjet, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.</p>

Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar (Kodi Penal, neni 327/a)

Votimi më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje, votimi për persona të tjerë, duke paraqitur dokumente identifikimi të rreme apo duke përdorur dokumente të zgjedhësve të tjerë dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Lejimi me dashje i kryerjes së kësaj veprë nga komisionerët zgjedhorë dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Lejimi me dashje nga komisionerët zgjedhorë i votimit, pa kryer identifikimin e shtetasit sipas ligjit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj deri në një vit.

Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (Kodi Penal, neni 329)

Kanosja që i bëhet zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën kundërvajtje penale.

Kanosja apo përdorimi i dhunës që i bëhet komisionerit, vëzhguesit, numëruesit si dhe çdo zyrtari tjetër të ngarkuar me zgjedhjet për ta penguar në kryerjen e detyrës apo për shkak të veprimtarisë së tij në administrimin zgjedhor dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Pengimi i zgjedhësit (Kodi Penal, neni 330)

Pengimi i zgjedhësit për të votuar në qendrën e tij të votimit, duke shkelur rregullat e votimit, duke i marrë apo dëmtuar dokumentin e tij të identifikimit, apo në çdo formë tjetër, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit.

Kur kjo veprë kryhet më shumë se një herë, ndaj më shumë se një zgjedhësi apo kur kryhet nga komisionerët zgjedhorë, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve (Kodi Penal, neni 330/a)

Braktisja e detyrës apo refuzimi për të kryer detyrën nga personat e ngarkuar me administrimin e procesit të votimit dhe të numërimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në dy vjet. Kur veprimet e mësipërme kryhen duke marrë me vete ose duke zhdukur materialet zgjedhore, ose kur kanë sjellë pasoja të rënda për procesin e votimit apo kanë çuar në pavlefshmërinë e zgjedhjeve, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROCESVERBAL

[Vulosjes së kutive të votimit përpara fillimit të votimit, për zgjedhjet e pjesëme për Kryetar të Bashkisë Kavajë, qarku Tiranë të datës 07 maj 2017

Baza ligjore: Nen 101 pika 1, përma e, i ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë", ndryshuar

KUJDES! Faqja e parë origjinale futet në kutinë e votimit para fillimit të procesit të votimit, ndërsa kopja duhet të futet në kutinë e materialeve zgjedhore.

KZAZ	NR. 42
Bashkia:	KAVAJE

Qarku:	TIRANE
Datë:	08.05.2017

1. Kutia e votimit për kandidatët për kryetar Bashkie mbyllet me këto vula me kodet e sigurisë:

1) 357247	2) 357248	3) 357249	4) 357250
-----------	-----------	-----------	-----------

Në rast se vula(t) me kodet e sigurisë dëmtohen gjatë mbylljes, ajo zëvendësohet me vulat rezervë me kodet:

1. 2. 3.

Komisioni i Qendrës së Votimit:

Kryetar:

Maria Nema
(emër, mbiemër, firmë)

Sekretari:

Luliana Zelis
(emër, mbiemër, firmë)

1. Anëtar: *Ambra Shkru*
(emër, mbiemër, firmë)
2. Anëtar: *Eno Rama*
(emër, mbiemër, firmë)
3. Anëtar: *Amesa Zoni*
(emër, mbiemër, firmë)
4. Anëtar: *Luli Patos*
(emër, mbiemër, firmë)
5. Anëtar: *Fjori Grandhi*
(emër, mbiemër, firmë)



ORA: 7:00



**REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

PROCESVERBAL

Lmblylljes së votimit, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kavajë, Qarku Tiranë, të datës 07 maj 2017

Baza ligjore: Neni 111 / Kapitulli 10 OTG, datë 28.12.2009 "Votat Zgjedhore / Republika të Shqipërisë", i kryeshuar

KZAZ: *M. H. H. 2*
KQV Nr: *216F*

Qarku: *TIRANË*
Datë: *07.05.2017*

KUDES! Faqja e parë origjinale e këtij procesverballi duhet të futet në kutinë e votimit për kryetarin e bashkisë, një kopje e tij duhet të futet në kutinë e materialeve zgjedhore.

Të dhëna për zgjedhësit dhe fletët e votimit		Me shifër	Me fjalë
Nr. i plotë i fletëve të votimit të QV-së/ për kandidatët për Kryetar Bashkie		<i>440</i>	<i>katërqind e dyzet</i>
Nr. i zgjedhësve që kanë votuar sipas nënshkrimeve të bërës së zgjedhësve të QV-së, si dhe atyre që janë në regjistrin e posaçëm	Gjithsej	<i>600</i>	<i>gjashtëqind</i>
	Femra	<i>250</i>	<i>dyqind e pesëdhjetë</i>
Nr. i fletëve të votimit - të papërdorura /për kandidatët për Kryetar Bashkie		<i>130</i>	<i>njëqind e tretëdhjetë</i>
Nr. i fletëve të votimit - të dëmtuara /për kandidat për Kryetar Bashkie		<i>10</i>	<i>dhjetë</i>
Vendosje të antarëve të KQV-së:			

I. Kodi i vulës së postë për mbylljen e kutisë së votimit për Kryetar Bashkie: Nr. *354251*

Në rast se vula(t) me kodet e sigurisë dëmtohen gjatë mbylljes, ajo zëvendësohet me vulën/vulat rezervë me kodet:

1. 2. 3.

II. Kutia e materialeve zgjedhore mbyllet me vulat me kode sigurie:

1. *354252* 2. *354253* 3. *354254* 4. *354255*

Komisioni i Qendrës së Votimit:

Kryetar: *Maria Nema*
(Emri, Prenomi, Titulli)

Sekretar: *Julian Zela*
(Emri, Prenomi, Titulli)

1. Anëtar: *Ambra Shkru*
(Emri, Prenomi, Titulli)

2. Anëtar: *Ema Pema*
(Emri, Prenomi, Titulli)

3. Anëtar: *Anesa Domi*
(Emri, Prenomi, Titulli)

4. Anëtar: *Luli Patosi*
(Emri, Prenomi, Titulli)

5. Anëtar: *Fjori Gramshi*
(Emri, Prenomi, Titulli)

VULA e KQV-së

Procesverballi u mbyll sot në datën *07.05.2017* ora: *20⁰⁰*

TEST MATËS I NJOHURIVE

1. Në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm:
 - a) anëtarët e KQV-së dhe zgjedhësit, që janë duke kryer procedurat e votimit;
 - b) anëtarët e KQV-së, zgjedhësit, që janë duke kryer procedurat e votimit si dhe vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe të huaj;
 - c) anëtarët e KQV-së dhe zgjedhësit, që janë duke kryer procedurat e votimit dhe vëzhguesit e partive politike.
2. Votuesit që nuk mund të votojnë vetë, ndihmohen nga:
 - a) një familjar që e ka emrin në listën e zgjedhësve;
 - b) anëtarët e KQV-së;
 - c) një zgjedhës [familjar ose jo], por që e ka emrin në listën e zgjedhësve të kësaj QV-je.
3. Zgjedhësit, që ka shënuar ose dëmtuar padashje fletën e votimit, dhe kërkon një fletë të dytë votimi:
 - a) I jepet një fletë tjetër votimi;
 - b) Edhe një fletë tjetër votimi, nqs shënimi ose dëmtimi padashje ndodh për herë të dytë;
 - c) Nuk i jepet fletë votimi;
 - d) I jepen dy fletë votimi.
4. Në rast se zgjedhësi shënon në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtësisë, KQV i jep atij:
 - a) një fletë tjetër votimi;
 - b) dy fletë votimi;
 - c) një fletë tjetër votimi, kur shënimi në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtësisë, bëhet për herë të dytë.
5. Nëse zgjedhësi bën shënim në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë ose e dëmton ose fotografon atë, kjo fletë votimi konsiderohet nga KQV-ja:
 - a) "E DËMTUAR";
 - b) "E DËMTUAR", kjo fletë votimi futet në zarfin "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA";
 - c) "E DËMTUAR", kjo fletë votimi futet në zarfin "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA" dhe rasti mbahet shënim në LPM të KQV-së.
6. Para se zgjedhësit t'i jepet fleta e votimit, ajo vuloset në pjesën e pasme të saj me:
 - a) vulën e KQV-së nga Sekretari dhe me vulën e Kryetarit të KQV-së nga Kryetari;
 - b) vulën e kryetarit të KQV-së nga Kryetari;
 - c) vulën e KQV-së nga Sekretari.
7. Në rast se të dhënat e një zgjedhësi në listën e zgjedhësve nuk përputhen me të dhënat e dokumentit të identifikimit:
 - a) Personi nuk ka të drejtë të votojë;
 - b) Emri dhe mbiemri i personit mbahet shënim në LPM dhe njoftohet KZAZ-ja.

8. Materialet zgjedhore për çdo KQV merren në dorëzim nga:
- Kryetari dhe Sekretari i KQV-së;
 - Kryetari dhe Sekretari i KQV-së, si dhe çdo anëtar i KQV-së që kërkon të jetë i pranishëm;
 - Të gjithë anëtarët dhe Sekretari i KQV-së.
9. Vendimet e KQV-së merren:
- me shumicën e votave të anëtarëve të KQV-së pjesëmarrës në mbledhje;
 - me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQV-së të KQV-së (minimumi 4), pjesëmarrës në mbledhje;
 - me votat e anëtarëve në detyrë, kur është urdhëruar nga KZAZ-ja (mungon kuorumi në KQV).
10. A ka të drejtë vote sekretari i KQV-së?
- Po;
 - Jo.
11. Vula e kryetarit të KQV-së përdoret:
- për vulosjen e LPM;
 - për vulosjen e çdo dokumenti të KQV-së;
 - vetëm për vulosjen e fletëve të votimit.
12. Dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit me të dhëna biometrike janë:
- Letërnjoftimi [Kartë identiteti] ose pasaportë;
 - Çdo dokument që vërteton identitetin e zgjedhësit.
13. Sekretari i KQV-së, pas mbylljes së votimit, me urdhërin e kryetarit të KQV-së, shënon në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, Model PV-KQV-08 dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve [LPM]:
- numrin epërgjithshëm të zgjedhësve, që kanë votuar, sipas nënshkrimeve të bëra në listën e zgjedhësve dhe në Regjistrin e Posaçëm të zgjedhësve,
 - numrin e epërgjithshëm të femrave, që kanë votuar,
 - numrin e fletëve të votimit të
 - numrin e plotë të fletëve të votimit të QV-së, duke u bazuar tek të dhënat e Procesverbalit PV-KQV-05
 - numrin e fletëve të votimit të papërdorura;
 - numrin e fletëve të votimit të dëmtuara;
 - pretendimet dhe vërejtjet e anëtarëve të KQV-së, nëse ka [shënohen në PV-KQV-08 dhe LPM];
 - vërejtjet e vëzhguesve, nëse ka [shënohen në LPM];
 - numrin [gjashtëshifrorë] të kodit të vulës së fundit [së pestë] të sigurisë të Kutisë së Votimit;
 - numrat [gjashtëshifrorë] të kodeve të vulave [katër vulave] të sigurisë të Kutisë së Materialeve Zgjedhore,
 - numrin e zgjedhësve, që kanë votuar, sipas nënshkrimeve të bëra në listën e zgjedhësve dhe në Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve.

14. Kur ndonjë nga vulat me kode sigurie dëmtohet gjatë mbylljes së kutisë së votimit ose kutisë së materialeve zgjedhore, ajo:
- Zëvendësohet me një vulë rezervë dhe kjo vulë shënohet në LPM;
 - Zëvendësohet me një vulë rezervë dhe kjo vulë shënohet në:
Librin e Protokollit të Mbledhjeve;
dhe
Procesverbalin e mbylljes së votimit, model PV-KQV-08;
 - Zëvendësohet me një vulë rezervë dhe kjo vulë shënohet në procesverbalin e mbylljes së votimit.
15. Fleta e votimit i jepet zgjedhësit, pasi:
- i është vërtetuar identiteti i tij dhe i është timbrosur gishti i madh i dorës së djathtë;
 - i është vërtetuar identiteti, ka nënshkruar në listën e zgjedhësve dhe i është timbrosur gishti i madh i dorës së majtë;
 - i ka paraqitur dokumentet e identifikimit dhe është vërtetuar që e ka emrin në listë.
16. Fleta e votimit i jepet zgjedhësit nga:
- Kryetari i KQV-së;
 - Sekretari KQV-së.
17. Të pranishëm, për vendimmarrje, një orë përpara se të fillojë votimi (në orën 6⁰⁰) duhet të jenë në QV:
- Të gjithë anëtarët;
 - Shumica e anëtarëve;
 - Të paktën 4 (katër) anëtarë duhet të jenë të pranishëm për vendimmarrje, në rast të kundërt duhet të njoftojnë KZAZ-në.
18. Kur KQV-ja mbetet pa kuorum, për shkak mungesave të anëtarëve dhe me kalimin e afatit, nuk është kryer zëvendësimi, KZAZ-ja urdhëron:
- vazhdimin e procedurave dhe merr masa për plotësimin kryesisht të vakancës;
 - vazhdimin e procedurave;
 - merr masa për plotësimin kryesisht të vakancës.
19. Anëtari i KQV-së voton në qendrën e votimit ku është emëruar anëtar komisioni dhe nëse emri i tij nuk është në listën e zgjedhësve të kësaj QV-je, por ai:
- bën deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve (LPM), ku
 - deklaron që nuk ka votuar në asnjë QV tjetër [i regjistruar sipas vendbanimit]
 - nënshkruan deklaratën,
dhe, pasi kryen këto veprime në LPM, ai nënshkruan krahas të dhënave të tij të shënuara nga Kryetari i KQV-së në Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve, para se të votojë,
 - Nënshkruan në Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve.

20. Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së votojnë tek qendra më e afërt e votimit dhe nëse emrat e tyre nuk janë në listën e zgjedhësve në këtë qendër votimi, ata shkruhen:
- në Regjistrin e Posaçëm dhe dhe Librin e Protokollit të Mbledhjeve (LPM). Vendimi i KZAZ-së, që i është dërguar KQV-së, i bashkangjitet Regjistrit të Posaçëm.
 - në Regjistrin e Posaçëm;
 - në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.
21. Çdo zgjedhës voton vetëm në emër të tij/saj dhe të ketë moshën 18 vjeç [qoftë edhe ditën e zgjedhjeve], i pajisur me një nga dokumentet e identifikimit të vlefshëm nëse:
- e ka emrin në listën e zgjedhësve;
 - ka vendim gjyqate, ku përcaktohet edhe numri i qendrës së votimit.
22. Në Qendrën e votimit ndalohe:
- Votimi në grup;
Votimi i hapur;
Votimi për të tjerë/Votimi në emër të të tjerëve;
Fotografimi i votës;
 - Votimi në grup.
23. Zgjedhësi nuk lejohet të votojë, kur:
- ka vendim gjyqate, por nuk ka dokumentin e identifikimit me vete;
 - nuk pranon të timbroset;
 - nuk ka emrin në listën që administron KQV;
 - do të ndihmojë më shumë se një zgjedhës;
 - do të votojë në emër të bashkëshortit/vjehrrit/djalit emigrant, etj.
 - nuk ka emrin në listën që administron KQV.
24. Cili është veprimi i parë që kryen zgjedhësi në QV?
- Të timbroset?
 - Të dorëzojë dokumentin e identifikimit?
 - Të nënshkruajë në listën e zgjedhësve të KQV-së?
 - Të thotë emrin përpara KQV-së?
25. Anëtarët dhe sekretari i KQV-së duhet të votojnë:
- përpara mbylljes së votimit, pasi kanë përfunduar procedurat e votimit zgjedhësit e pranishëm, në radhë, të cilëve iu është marrë dokumenti i identifikimit në orarin e caktuar për mbylljen e votimit.
 - pak pas fillimit të votimit.

26. Kryetari i KQV-së, merr në dorëzim Vulën e Kryetarit nga KZAZ-ja, në praninë e anëtarëve të KZAZ-së, dhe kryen sipas radhës veprimet e mëposhtme:
- merr me zgjedhje rastësore një vulë nga grumbulli përkatës i vulave të paketuara.
 - gris ambalazhin e vulës,
 - vulos, në një letër të bardhë për të bërë modelin e krahasimit të vulës,
 - shënon emrin dhe mbiemrin e tij, si dhe nënshkruan nën modelin krahasues të vulës në prani të anëtarëve të KZAZ-së.
 - Anëtarët e KZAZ-së nënshkruajnë në pjesën e pasme të letrës së bardhë me modelin krahasues (specimenin) të Vulës së Kryetarit të KQV-së dhe mbahet në ruajtje nga Sekretari i KZAZ-së në një dosje të veçantë sëbashku me Modelin PV-KZAZ-06;
 - a, b, c, ç, d së bashku.
27. Pas mbylljes së votimit, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm:
- anëtarët dhe sekretari i KQV-së, si dhe vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe të huaj si dhe përfaqësuesit e akredituar të medias;
 - anëtarët dhe sekretari i KQV-së, vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe të huaj;
 - anëtarët, sekretari i KQV-së dhe vëzhguesit e partive politike.
28. Në Procesverbalin e mbylljes së votimit, PV-KQV-08, shënohet në fillim numri i plotë i fletëve të votimit të QV-së, të marra nga KZAZ-ja me Procesverbalin për pajisjen e KQV-së me materiale zgjedhore, PV-KQV-05:
- Po.
 - Jo.
29. Kutia e votimit me fletët e votimit dhe Kutia e Materialeve të Votimit nga KQV-ja në dorëzohen në KZAZ/VNV:
- jo më vonë se 3 orë pas mbylljes së procesit të votimit, dhe dokumentohet në Procesverbalin Model PV–KZAZ–09, një kopje të tij e marrin:
 - Sekretari i KQV-së;
 - Punonjësi i policisë që ka shoqëruar Kutinë e Votimit me fletët e votimit dhe Kutinë e Materialeve të Votimit.
 - jo më vonë se 1 orë pas mbylljes së procesit të votimit.
30. Lejimi me dashje nga komisionerët zgjedhorë i votimit, pa kryer identifikimin e shtetasit sipas ligjit, përbën:
- kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj deri në një vit.
 - kundërvajtje penale.
31. Votimi më shumë se një herë në të njëjtën zgjedhje, votimi për persona të tjerë, duke paraqitur dokumente identifikimi të rreme apo duke përdorur dokumente të zgjedhësve të tjerë dënohet:
- me burgim nga një deri në tre vjet.
 - me gjobë.
32. Lejimi me dashje i kryerjes së veprës së mësipërme (pyetja 31), votimi më shumë se një herë.... nga komisionerët zgjedhorë dënohet:
- me burgim nga një deri në pesë vjet.
 - me gjobë.

33. Dëmtimi i qëllimshëm ose nxjerrja e vulës jashtë qendrës së votimit përbën:
- vepër penale dhe ndëshkohet sipas nenit 326/a të Kodit Penal.
 - vepër penale.
34. Anëtari i caktuar me detyrë për orientimin e zgjedhësit për të hedhur fletën e votimit në kutinë e votimit, tregohet i kujdesshëm që:
- zgjedhësi të mos largohet nga QV pa e hedhur fletën e votimit në kutinë e votimit;
 - fleta e votimit të jetë e palosur dhe një nga vulat në pjesën e pasme të jetë e dukshme dhe zgjedhësi të mos largohet nga QV pa e hedhur fletën e votimit në kutinë e votimit.
35. Anëtari i caktuar me detyrë për timbrimin me bojë speciale zgjedhësin, pasi është pajisur me fletën e votimit, në rastin kur zgjedhësi nuk pranon të timbroset:
- lejon zgjedhësin të votojë;
 - nuk duhet ta lejojë zgjedhësin të votojë;
 - njofton KQV-në, se zgjedhësi refuzon timbrimin, dhe duhet të bëhet shënim:
 - ✓ në Listën e zgjedhësve nga Kryetari;
 - ✓ në LPM nga Sekretari, i cili i merr zgjedhësit edhe fletën e votimit.
36. Anëtari i KQV-së i ngarkuar me detyrë për të kontrolluar zgjedhësin nëse është ose jo i timbruar me bojën speciale, që
- lejon zgjedhësin e timbruar të votojë, mban përgjegjësi administrative;
 - lejon zgjedhësin e timbruar të votojë, mban përgjegjësi penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, përjashtim bën zgjedhësi [familjar ose jo], i cili ndihmon zgjedhësin që nuk mund të votojë vetë [neni 108 i Kodit Zgjedhor].
37. Shkelja e rregullave, nga ana e personave përgjegjës për zgjedhjet, që garantojnë fshehtësinë e votimit përbën:
- kundërvajtje penale;
 - kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.
38. Vëzhguesit shqiptarë dhe të huaj që vëzhgojnë procesin e votimit në QV akreditohen nga KQZ-ja ose KZAZ-ja.
- Çdo koalicion ka të drejtë të caktojë tre vëzhgues.
 - Kandidatët e partive politike, nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues.
 - Kandidatët nuk lejohen të jenë të pranishëm në QV, përveç rastit kur janë duke votuar!
- Po
 - Jo
39. Hapësira e kapakut të kutisë së votimit, ku hidhet fleta e votimit, vuloset:
- me vulën e fundit [të pestë], me kode sigurie, me ngjyrë bezhë, pas procesit të mbylljes së votimit;
 - me vulën e fundit [të pestë], me kode sigurie.

40. Dërgimi i informacionit për pjesëmarrjen në votim nga KQV-ja në KZAZ ditën e votimit kryhet nga:

- a) Sekretari i KQV-së;
- 07:00 Informacion për orën e hapjes së qendrës së votimit;
 - 10:00 Informacion për numrin e pjesëmarrjes në votim (nr. i zgjedhësve, që kanë votuar);
 - 13:00 Informacion për numrin e pjesëmarrjes në votim;
 - 16:00 Informacion për numrin e pjesëmarrjes në votim;
 - 18:00 Informacion për orën e mbylljes së qendrës së votimit (sipas rastit),
 - Në mbylljen të procesit të votimit:
 - ✓ numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar në atë QV;
 - ✓ numrin/shifrën e femrave që kanë votuar.
- b) Kryetari i KQV-së;
- c) Një nga anëtarët e KQV-së.

PËRGJIGJET E TESTIT

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja	b	c	b	c	c	a	a, b	a, b	a, b, c	a
Pyetja	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Përgjigja	c	a	a	b	b	b	a, b, c	a	a	a
Pyetja	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
Përgjigja	a, b	a, b	a, b	d	a	dh	a	a	a	a
Pyetja	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
Përgjigja	a	a	a	b	b	b	b	a	a	a



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
www.cec.org.al

VOTO!

Zgjedhjet për Kryetarin e
Bashkisë Kavajë

7 MAJ 2017

Rruga "Ibrahim Rugova", nr.4/1

Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së 047235231

Drejtorja e Komisioneve Zgjedhore 047235237

e-mail: Dkz@cec.org.al

Spektori i Trajnimit 047235264

e-mail: Trajnime.Kqz@cec.org.al